



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

Raport i punës
së Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës
për Shërbimin Civil të Kosovës për
vitin 2016

Prishtinë
Mars 2017

FJALA E KRYETARIT TË KËSHILLIT TË PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS, SHKËMB MANAJ

Kam nderin dhe kënaqësinë e veçantë, që të prezentoj Raportin vjetor të punës së Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për vitin 2016. Ky raport, pasqyron kryerjen e funksioneve kushtetuese dhe ligjore të Këshillit, si institucion i pavarur kushtetues për mbikëqyrjen e respektimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit të shërbimit civil.

Shërbimi civil i Republikës së Kosovës, është kategori kushtetuese dhe njëra prej segmenteve kryesore të administratës publike, që ka rol kyç në ofrimin e shërbimeve profesionale dhe të shpejta për qytetarët dhe bizneset, si dhe në zhvillimin e gjithmbarshëm të proceseve shtetndërtuese dhe të integritit euroatlantik të Republikës së Kosovës.

Në këtë pikëpamje, Këshilli më profesionalizëm është angazhuar që të siguroj zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil, për të garantuar, që ky shërbim të jetë profesional dhe i paanshëm, si dhe të pasqyroj diversitetin e popullit të Kosovës, duke përfshirë parimin e barazisë gjinore.

Më këtë rast, falënderoj anëtarët e Këshillit për përkushtimin dhe profesionalizimin e treguar, duke bërë që Këshilli të vendos për të gjitha ankesat, brenda afateve të përcaktuara me ligj. Po ashtu, falënderoj drejtorin ekzekutiv, bashkëpunëtorët profesional dhe nëpunësit tjerë të sekretarisë, që kanë ofruar mbështetjen e tyre profesionale dhe administrative, fal të cilës kemi arritur që t'i realizojmë me sukses funksionet e Këshillit.

Këshilli në përbërje të plotë, me datën 20 qershor 2016, më ka zgjedhur me vota unanime për të udhëhequr këtë institucion të rëndësishëm dhe detyrën e kam filluar me datën 1 korrik 2016. Kalimi i udhëheqjes së Këshillit nga Kryetari, z. Lulzim Aliaj tek unë, mbetet një shembull i transferit normal të përgjegjësisë dhe vazhdimësisë së punës në Këshill. Më këtë rast, shpreh konsideratën time dhe të anëtarëve të Këshillit, për punën e madhe që ka kryer z. Aliaj në udhëheqjen e Këshillit gjatë mandatit të tij.

Raporti vjetor i punës, përfshinë të dhëna për punët e kryera në kuadër të funksionit të zgjidhjes së ankesave të nëpunësve civilë dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil, funksionit të vëzhgimit të procedurës së emërimit të nëpunësve civil të nivelit drejtues si dhe funksionit të mbikëqyrjes së zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, përfaqësimin e Këshillit në procedura gjyqësore, bashkëpunimin e Këshillit me institucionet vendore dhe ndërkombëtare si dhe pjesëmarrjen e Këshillit në konferenca dhe takime të rëndësishme lidhur me proceset reformuese në administratën publike.

Po ashtu, Këshilli në këtë raport, ndryshe nga raportet pararendese, në detaje prezenton një vlerësim të përgjithshëm të gjendjes në shërbimin civil në 18 fusha, duke konstatuar shkeljet dhe duke dhënë rekomandimet konkrete për Qeverinë dhe Kuvendin e Republikës së Kosovës si dhe për institucionet tjera të administratës publike. Risi tjetër, në këtë raport është prezentimi i zbatimit të legjislacionit lidhur me përfaqësimin etnik dhe gjinor në shërbimin civil, të dhënat lidhur me mënyrën e vendimmarjes së gjykatave lidhur me paditë e ngritura kundër vendimeve të

Këshillit të cilat janë vendosur gjatë vitit 2016 si dhe publikimi i vendimeve të pazbatuara, institucionet që nuk i kanë zbatuar vendimet e Këshillit dhe personat përgjegjës për zbatimin/moszbatimin e vendimeve të Këshillit.

Lidhur me legjislacionin, Këshilli gjatë vitit 2016 ka nxjerrë katër Rregullore që përcaktojnë organizimin e brendshëm dhe rregullat dhe procedurat për kryerjen e funksioneve ligjore të Këshillit. Në muajin dhjetor, i kemi dërguar kërkesë Komisionit për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media të Kuvendit të Republikës së Kosovës për të ndërmarr nismën e Plotësimit dhe Ndryshimit të Ligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civilë sepse kemi vlerësuar që ky Ligj duhet të plotësohet dhe ndryshohet duke i dhënë propozimet konkrete, që të shkurtohen afatet e vendimmarrjes në Këshill nga 60 ditë në 45 ditë, të shtohen sanksione ndaj personave përgjegjës për zbatimin e vendimeve në rastin e moszbatimit të tyre, të fuqizohen kriteret për emërimin e anëtarëve të Këshillit, etj.

Sa i përket kushteve të punës, Këshilli gjatë vitit 2016 është ballafaquar më vështirësi në punën e vet për shkak të hapësirave të pamjaftueshme për punë dhe për shkak të buxhetit minimal për kryerjen e funksioneve ligjore. Por, në Ligjin për Buxhet për vitin 2017, Qeveria dhe Kuvendi i Kosovës, kanë aprovuar kërkesat e Këshillit për rritjen e buxhetit në kategorinë ekonomike të mallrave dhe shërbimeve. Po ashtu, Ministria e Administratës Publike ka mundësuar që tani Këshilli dhe sekretaria të punojnë në kushte më të mira të punës.

Këshilli gjatë vitit 2016, në kuadër të bashkëpunimit më jashtë, ka pritur në një vizitë pune, Komisionerën e Shërbimit Civil të Republikës së Shqipërisë si dhe ka marrë pjesë në konferencën “Drejtësia Administrative në Ballkanin Përendimorë” të mbajtur në Podgoricë nën organizimin e Shkollës Regjionale për Administratë Publike - RESPA në bashkëpunim me Gjykatën Administrative dhe Gjykatën Kushtetuese të Malit të Zi. Me këtë rast, përfaqësuesit e Këshillit kanë pasur rastin të takohen dhe të shkëmbejnë përvojat me përfaqësues të institucioneve të administratës publike, duke përfshirë kryetarë dhe gjyqtarë të gjykatave administrative nga vendet e Ballkanit Përendimorë.

Shpresoj që ky Raport do t’ju hyj në punë institucioneve të administratës publike që hartojnë politikat e shërbimit civil, nëpunësve civilë, studiuesve dhe organizatave tjera qeveritare dhe joqeveritare kombëtare dhe ndërkombëtare, që në fushëpërimin e tyre e kanë administratën publike, respektivisht shërbimin civilë.

Rekomandimet e dhëna në këtë Raport, nëse adresohen, do të ndikojnë në reformimin e administratës publike dhe në avancimin e shërbimit civilë të Republikës së Kosovës.

Ju uroj lexim të këndshëm.

Shkëmb MANAJ

Kryetar i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

TABELA E PËRMBAJTJES

| | | |
|-------|---|----|
| 1. | Përmbledhje ekzekutive | 5 |
| 2. | Korniza ligjore | 6 |
| 3. | Fushëveprimi i Këshillit | 6 |
| 4. | Organizimi i Këshillit | 7 |
| 5. | Aktivitetet e Këshillit për periudhën raportuese | 9 |
| 5.1. | Funksioni i shqyrtimit të ankesave | 9 |
| 5.1.1 | Ankesat e pranuar sipas objektit | 9 |
| 5.1.2 | Ankesat e pranuar sipas strukturës gjinore të ankuesëve | 11 |
| 5.1.3 | Ankesat e pranuar sipas strukturës etnike të ankuesëve | 12 |
| 5.1.4 | Ankesat e pranuar sipas institucioneve ndaj vendimeve të të cilave është paraqitur ankesë | 13 |
| 6. | Ankesat e pranuar kundër vendimeve të institucioneve | 15 |
| 6.1 | Ankesat kundër vendimeve të institucioneve të administratës qendrore | 15 |
| 6.2 | Ankesat kundër vendimeve të institucioneve të administratës lokale | 22 |
| 7. | Ndarja e ankesave sipas formës së vendosjes | 24 |
| 7.1. | Të aprovuara | 24 |
| 7.2. | Pjesërisht të aprovuara | 24 |
| 7.3. | Të refuzuara | 24 |
| 7.4. | Të hedhura poshtë | 24 |
| 7.5. | Të shpallura jo-kompetent | 24 |
| 7.6. | Detyrimi i organit administrativ për të nxjerr aktin administrativ | 25 |
| 7.7. | Kthimi në rishqyrtim | 25 |
| 7.8. | Përfundim i procedimit administrativ | 25 |
| 8. | Formate vendosjes kundër vendimeve të institucioneve | 27 |
| 8.1. | Format e vendosjes kundër vendimeve të institucioneve të administratës qendrore | 27 |
| 8.2. | Format e vendosjes kundër vendimeve të institucioneve të administratës lokale | 30 |
| 9. | Zbatimi i vendimeve të Këshillit nga organet e punësimit | 31 |
| 10. | Funksioni i mbikëqyrjes së zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil | 35 |
| 11. | Funksioni i vëzhgimit të procedurës së emërimit të nëpunësve civil të nivelit drejtues | 38 |
| 12. | Rekomandimet dhe sfidat e Këshillit | 41 |
| 13. | Vlerësimi i përgjithshëm i respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil të Republikës së Kosovës | 43 |
| 14. | Vendimet e Gjykatave | 71 |
| 15. | Bashkëpunimi i Këshillit me institucionet e tjera | 71 |
| 16. | Krahasimi i punës së Këshillit për vitin 2015 me punën e Këshillit për vitin 2016 | 72 |
| 17. | Raporti për shpenzimin e buxhetit të Këshillit | 75 |

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Raporti i punës për vitin 2016, përmban të dhëna dhe informata të detajuara, për të gjitha aktivitetet dhe punët e kryera nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Në raport përfshihen të dhëna për punët e kryera në kuadër të funksionit të zgjidhjes së ankesave të nëpunësve civilë dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil, funksionit të vëzhgimit të procedurës së emërimit të nëpunësve civil të nivelit drejtues dhe funksionit të mbikëqyrjes së zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil.

Po ashtu, në këtë Raport janë përfshirë edhe aktivitetet tjera të Këshillit, si përfaqësimi i Këshillit në procedura gjyqësore, bashkëpunimi i Këshillit me institucionet vendore dhe ndërkombëtare si dhe pjesëmarrjen e Këshillit në konferenca dhe takime të rëndësishme lidhur me proceset reformuese në administratën publike .

Këshilli gjatë vitit 2016, ka arritur që të shqyrtojë dhe vendos në mënyrë meritore për 571 ankesa të nëpunësve civilë dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil, prej të cilave 514 ankesa të pranuar gjatë vitit 2016 dhe 57 ankesa të cilat janë bartur nga viti 2015 për vendosje në vitin 2016.

Këshilli gjatë vitit 2016, ka vëzhguar (248) pozita të rekrutimit lidhur me procesin e emërimeve të nëpunësve civil të nivelit drejtues. Nga (248) pozita që janë vëzhguar, Këshilli ka aprovuar si të rregullta (104) pozita të rekrutimit, ndërsa për shkak të shkeljeve ligjore dhe procedurale, ka anuluar (144) pozita të rekrutimit të nëpunësve civilë të nivelit drejtues.

Në kuadër të funksionit të mbikëqyrjes së zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit në pajtim me Planin e Monitorimit, Këshilli ka realizuar (57) vizita monitoruese të mbikëqyrjes së zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil.

Në raportet e mbikëqyrjes së zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil për institucione të nivelit qendror dhe lokal, Këshilli ka evidentuar dhe ka konstatuar rreth (337) shkelje të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, dhe për shkeljet e evidentuara ka dhënë (245) rekomandime për zyrtarët përgjegjës të institucioneve të monitoruara.

2. KORNIZA LIGJORE

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kryen funksionet dhe përgjegjësitë në pajtim me:

- Kushtetutën e Republikës së Kosovës,
- Ligjin nr.03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës,
- Ligjin nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës,
- Ligjinnr.02/L-028 për Procedurën Administrative,
- Rregulloren nr.02/2016 për Punën e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës,
- Rregulloren nr. 03/2016 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës,
- Rregulloren Nr.01/2015 për Rregullat dhe Procedurat e Vëzhgimit për Emërimin e Nëpunësve Civil të Nivelit Drejtues.
- Rregulloren Nr.04/2016 për procedurat e Mbikqyrëjes së Zbatimit të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil në Institucionet e Administratës Publike

Vështirësitë që kryesisht është përballur Këshilli, e që ndërliken me bazën ligjore, përfshijnë mosmiratimin e të gjitha akteve nënligjore për shërbimin civil, kolizionin e dispozitave ligjore në mes të ligjeve por edhe në mes të akteve nënligjore, paqartësitë e krijuara me kategoritë e nëpunësve civilë dhe nëpunësve tjerë në mungesë të përfundimit të klasifikimit të vendeve të punës si dhe mos zbatimin e obligimeve ligjore për organizimin dhe strukturimin e administratës shtetërore.

Këshilli në dhjetor të vitit 2016, ka proceduar kërkesën në Komisionin për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media të Kuvendit të Republikës së Kosovës për nëvojen e Plotësimit dhe Ndryshimit të Ligjit Nr.03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke dhënë edhe arsyetimin për pikat që duhet të ndryshohen dhe plotësohen.

Po ashtu, Këshilli ka marr pjesë aktive në plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Shërbimin Civilë dhe Ligjin për Konfliktin Administrativ.

3. FUSHËVEPRIMI I KËSHILLIT

Këshilli është organ i pavarur i cili mbikëqyr respektimin e të gjitha rregullave dhe parimeve që rregullojnë Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës dhe për punën e tij i raporton drejtpërdrejtë Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është paraparë me nenin 101 paragrafin 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës si dhe me Ligjin Nr.03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Me dispozitat e Ligjit nr.03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës janë përcaktuar funksionet e Këshillit si në vijim:

- shqyrton dhe merr vendime për ankesat e nëpunësve civilë kundër vendimeve të organit të punësimit në të gjitha institucionet e Shërbimit Civil në përputhje me rregullat dhe parimet e parashtruara në Ligjin për Shërbim Civil të Republikës së Kosovës;
- vendos nëse emërimet e nëpunësve civil të nivelit drejtues janë bërë në përputhje me rregullat dhe parimet e parashtruara në Ligjin për Shërbim Civil të Republikës së Kosovës;
- mbikëqyr zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil.

Me qëllim të ushtrimit të funksioneve, Këshilli mund të:

- vizitojë çdo vend ku janë të punësuar nëpunësit civilë;
- ketë qasje dhe t'i kontrollojë të dhënat me shkrim lidhur me punësimin, emërimin, procedurat disiplinore dhe avancimin e nëpunësve civilë ose lidhur me shqyrtimin dhe vendimet për ankesa;
- intervistojë çdo nëpunës civil, i cili mund të ketë informata që kanë rëndësi të drejtpërdrejtë për ushtrimin e funksioneve të Këshillit.

4. ORGANIZIMI I KËSHILLIT


Organizimi i brendshëm i Këshillit është i rregulluar me Ligjin Nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe me Rregulloren Nr.01/2016 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Me dispozitat e këtij Ligji është përcaktuar edhe përbërja e Këshillit, ku përcaktohet që Këshilli përbëhet prej shtatë (7) anëtarëve, që emërohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, në bazë të procedurave të hapura dhe transparente, dhe po ashtu që përbërja e Këshillit pasqyron karakterin shumë etnik dhe gjinor.

Mandati i të gjithë anëtarëve të Këshillit është 5 vjeçar me mundësi rizgjedhje. Kryetari i Këshillit zgjidhet nga anëtarët e Këshillit me mandat dy vjeçar.

Sekretariati i Këshillit i ofron mbështetje Këshillit në ushtrimin e funksioneve kushtetuese dhe ligjore. Sekretariati udhëhiqet nga Drejtori Ekzekutiv dhe ka te punësuar 19 nëpunës civil . Në kuadër të Sekretariatit funksionojnë dy departamente: Departamenti për Mbështetje Profesionale dhe Departamenti për Finanaca dhe Shërbime të Përgjithshme.

Organogrami i Këshillit dhe Sekretariatit



5. AKTIVITETET E KËSHILLIT PËR PËRIUDHËN RAPORTUESE

Në vijim të raportit, paraqesim një pasqyrim të plotë të mënyrës së ushtrimit të funksioneve nga Këshilli, respektivisht për procesin e shqyrtimit të ankesave, procesin e vëzhgimit të emërimeve të nëpunësve civil të nivelit drejtues dhe procesin e mbikëqyrjes së zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë periudhës raportuese **1 Janar -31 Dhjetor 2016**.

5.1.FUNKSIONI I SHQYRTIMIT TË ANKESAVE

Këshilli gjatë vitit 2016 ka pranuar gjithsej **596** ankesa të cilat janë parashtruar nga nëpunësit civilë, si dhe nga kandidatët për praninë në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Këshilli, përveç **596** ankesave të pranuar, në shqyrtim ka pasur edhe **58** ankesa, të cilat janë bartur nga viti 2015 për vendosje në vitin 2016. Bazuar në këto të dhëna, rezulton që Këshilli gjatë vitit 2016 ka pasur në shqyrtim gjithsej **654** ankesa.

Këshilli ka vendosur në mënyrë meritore për **571** ankesa ndërsa **83** ankesa janë bartur për tu vendosur brenda afatit ligjor në vitin 2017. Ankesat e bartura për vitin 2017 janë ankesa të pranuar kryesisht gjatë muajit Dhjetor 2016.

Ky raport përmban të dhëna statistikore për ankesat e pranuar sipas:

1. objektit të ankesës,
2. strukturës gjinore të ankuesve,
3. strukturës etnike të ankuesve dhe
4. institucioneve ndaj vendimeve të të cilave është paraqitur ankesë.


5.1.1.Ankesat e pranuar sipas objektit të ankesës

Në Këshill, janë pranuar ankesa, të cilat kanë pasur objekt të ndryshëm të ankimimit dhe të ndara sipas llojit të objektit. Ndarja e ankesave sipas objektit pasqyrohet në numra dhe në përqindje në tabelën në vijim :


| Nr. | Objekti i ankesave | Numri i ankesave | Përqindja |
|-----|------------------------------------|------------------|-----------|
| 1 | Kontestim konkursi | 205 | 34.39% |
| 2 | Kompensim material | 80 | 13.42% |
| 3 | Ndërprerje e marrëdhënies së punës | 62 | 10.40% |
| 4 | Transferime | 53 | 8.89% |
| 5. | Kërkesa nga marrëdhënia e punës | 51 | 8.55% |
| 6 | Masë disiplinore | 44 | 7.38% |
| 7 | Pezullim parandalues | 31 | 5.20% |
| 8 | Shkelje e të drejtës në pagë | 21 | 3.52% |

| | | | |
|----|--|------------|---------------|
| 9 | Vlerësim i Punës | 19 | 3.18% |
| 10 | Moszbatim i vendimeve të Komisioneve | 11 | 1.84% |
| 11 | Mos vazhdim i kontratës së punës | 8 | 1.34% |
| 12 | Ulje në pozitë | 5 | 0.83% |
| 13 | Çështje të avancimit në karrier | 5 | 0.83% |
| 14 | Kundër caktimit të ushtruesit të detyrës | 1 | 0.16% |
| | Gjithsejtë: | 596 | 99.93% |

Tabela nr. 1 paraqet ankesat e pranuar sipas objektit të ankesës në vitin 2016



Diagrami nr.1 paraqet të dhënat e tabelës nr.1




Vazhdim i diagramit nr.1

5.1.2. Ankesat e ushtruara sipas strukturës gjinore të ankuesve

Nga 596 ankesa të pranuar në vitin 2016, ndarja sipas strukturës gjinore të ankuesve është si në vijim: ankues meshkuj kanë qenë 405 ose 67.95%, ndërsa ankuese femra kanë qenë 191 ose 32.04%.

| Nr. Rendor | Ankesat e ushtruara sipas strukturës gjinore | Numri | Përqindja |
|------------|--|-------|-----------|
| 1 | Meshkuj | 405 | 67.95% |
| 2 | Femra | 191 | 32.02% |

Tabela nr. 2 paraqet ankesat e pranuar sipas strukturës gjinore të ankuesve




Diagrami nr.2 paraqet të dhënat e tabelës nr.2

5.1.3. Ankesat e pranuar sipas strukturës etnike të ankuesve

Nga 596 ankesa të pranuar në vitin 2016, nga ankuesit e përkatësisë etnike shqiptare janë pranuar 538 ankesa ose 90.27% e numrit të përgjithshëm të ankesave. Nga ankuesit e përkatësisë etnike serbe janë pranuar 53 ankesa ose 8.89% e numrit të përgjithshëm të ankesave. Nga ankuesit e përkatësisë etnike boshnjake janë pranuar 5 ankesa ose 0.83% e numrit të përgjithshëm të ankesave.

| Nr.rendor | Ankesat e pranuar sipas strukturës etnike të ankuesve | Numri i ankesave | Përqindja |
|-----------|---|------------------|-----------|
| 1 | Shqiptar | 538 | 90.27% |
| 2 | Serb | 53 | 8.89% |
| 3 | Boshnjak | 5 | 0.83% |

Tabela nr. 3 paraqet ankesat e pranuar sipas strukturës etnike të ankuesve




Diagrami nr.3 paraqet të dhënat e tabelës nr.3

5.1.4. Ankesat e pranuar sipas institucioneve kundër vendimeve të cilave është paraqitur ankesë

Këshilli, gjatë periudhës raportuese ka pranuar ankesa nga nëpunësit civilë dhe nga kandidatët për pranim në shërbimin civil, të parashtruara kundër vendimeve të organeve të punësimit, si në vijim: 350 ankesa ose 58.73% e numrit të përgjithshëm të ankesave janë parashtruar kundër vendimeve të institucioneve të administratës qendrore si dhe 247 ankesa ose 41.44% e numrit të përgjithshëm të ankesave janë parashtruar kundër vendimeve të institucioneve të administratës lokale.

| Nr. | Ankesat e pranuar sipas institucioneve kundër vendimeve të cilave është paraqitur ankesë | Numri i ankesave | Përqindja |
|-----|--|------------------|-----------|
| 1 | Institucionet e administratës qendrore | 350 | 58.73% |
| 2 | Institucionet e administratës lokale | 246 | 41.27% |

Tabela nr. 4 paraqet ankesat e pranuar sipas institucioneve kundër vendimeve të cilave është paraqitur ankesë.



Diagrami nr. 4 paraqet të dhënat e tabelës nr.4

6. ANKESAT E PRANUARA KUNDËR VENDIMEVE TË INSTITUCIONEVE

6.1. Ankesat kundër vendimeve të institucioneve të administratës qendrore

Këshilli, gjatë periudhës raportuese ka pranuar 350 ankesa kundër vendimeve të institucioneve të administratës qendrore, të cilat pasqyrohen si në vijim:

| Nr. | Institucionet e Administratës Qendrore | Numri i Ankesave | Përqindja |
|-----|---|------------------|-----------|
| 1 | Ministria e Infrastrukturës | 42 | 7.05% |
| 2 | Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës | 21 | 3.52% |
| 3 | Ministria e Punëve të Jashtme | 16 | 2.7% |
| 4 | Ministria e Financave | 16 | 2.7% |
| 5 | Ministria e Tregtisë dhe Industrisë | 15 | 2.52% |
| 6 | Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë | 15 | 2.52% |
| 7 | Ministria e Punëve të Brendshme | 14 | 2.35% |
| 8 | Ministria e Shëndetësisë | 14 | 2.35% |
| 9 | Administrata Tatimore e Kosovës | 12 | 2.01% |
| 10 | Agjencia e Statistikave të Kosovës | 10 | 1.68% |
| 11 | Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale | 10 | 1.68% |
| 12 | Agjencia Kosovare e Privatizimit | 9 | 1.51% |
| 13 | Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit | 9 | 1.51% |
| 14 | Policia e Kosovës | 8 | 1.34% |
| 15 | Ministria e Administratës Publike | 7 | 1.17% |
| 16 | Ministria e Diasporës | 7 | 1.17% |
| 17 | Shërbimi Korrektues i Kosovës | 7 | 1.17% |
| 18 | Gjykata Themelore Gjilan | 6 | 1.00% |
| 19 | Gjykata Themelore në Prishtinë | 6 | 1.00% |
| 20 | Prokuroria e Shtetit | 6 | 1.00% |
| 21 | Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore | 5 | 0.84% |
| 22 | Dogana e Kosovës | 5 | 0.84% |
| 23 | Gjykata Themelore Ferizaj | 5 | 0.84% |
| 24 | Këshilli Prokurorial i Kosovës | 5 | 0.84% |
| 25 | Ministria e Zhvillimit Ekonomik | 4 | 0.67% |
| 26 | Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor | 4 | 0.67% |
| 27 | Universiteti i Gjakovës | 4 | 0.67% |
| 28 | Gjykata Supreme e Kosovës | 4 | 0.67% |
| 29 | Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale | 4 | 0.67% |
| 30 | Agjencia Pyjore e Kosovës | 3 | 0.50% |
| 31 | Universiteti i Prishtinës | 3 | 0.50% |
| 32 | Biblioteka Kombëtare e Kosovës | 3 | 0.50% |
| 33 | Autoriteti Kosovar i Konkurrencës | 3 | 0.50% |
| 34 | Kuvendi i Republikës së Kosovës | 3 | 0.50% |
| 35 | Universiteti i Pejës | 3 | 0.50% |
| 36 | Organi Shqyrtues i Prokurimit | 2 | 0.33% |
| 37 | Këshilli i Pavarur Mbikëqyres për Shërbimin Civil | 2 | 0.33% |

| | | | |
|----|--|------------|---------------|
| 38 | Agjencioni Kadastral i Kosovës | 2 | 0.33% |
| 39 | Akademia e Kosovës për Siguri Publike | 2 | 0.33% |
| 40 | Gjykata e Apelit Prishtinë | 2 | 0.33% |
| 41 | Gjykata Themelore Mitrovicë | 2 | 0.33% |
| 42 | Zyra e Kryeministrit | 2 | 0.33% |
| 43 | Zyra e Rregullatorit për Energji | 2 | 0.33% |
| 44 | Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal | 2 | 0.33% |
| 45 | Zyra e Auditorit të Përgjithshëm | 1 | 0.17% |
| 46 | Ministria e Drejtësisë | 1 | 0.17% |
| 47 | Teatri Kombëtarë i Kosovës | 1 | 0.17% |
| 48 | Ministria e Forcës dhe Sigurisë së Kosovës | 1 | 0.17% |
| 49 | Ministria për Komunitete dhe Kthim | 1 | 0.17% |
| 50 | Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural | 1 | 0.17% |
| 51 | Komisioni Qendror i Zgjedhjeve | 1 | 0.17% |
| 52 | Agjencia Kosovare e Pronës | 1 | 0.17% |
| 53 | Agjencioni Kundër Korrupsionit | 1 | 0.17% |
| 54 | Agjencia e Akreditimit të Kosovës | 1 | 0.17% |
| 55 | Agjencia e Kosovës për Intelegjencë | 1 | 0.17% |
| 56 | Agjencia e Kosovës për Mbrojtje nga Rrezatimi | 1 | 0.17% |
| 57 | Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror | 1 | 0.17% |
| 58 | Agjencioni për Ndihmë juridike Falas | 1 | 0.17% |
| 59 | Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale | 1 | 0.17% |
| 60 | Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës | 1 | 0.17% |
| 61 | Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave | 1 | 0.17% |
| 62 | Gjykata Themelore Prizren | 1 | 0.17% |
| 63 | Gjykata Themelore Pejë | 1 | 0.17% |
| 64 | Qendra Klinike Universitare | 1 | 0.17% |
| 65 | Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare Ferizaj | 1 | 0.17% |
| 66 | Universiteti i Mitrovicës | 1 | 0.17% |
| 67 | Gjykata Themelore Podujevë | 1 | 0.17% |
| 68 | Gjykata Themelore Gjakovë | 1 | 0.17% |
| | Gjithsejt: | 350 | 58.73% |

Tabela nr. 5 paraqet të dhënat për numrin dhe përqindjen e ankesave të arritura në Këshill, gjatë vitit 2016, kundër vendimeve të institucioneve të administratës qendrore.

| Ankesat e pranuara Kundër vendimeve të Institucioneve të Administratës qendrore sipas objektit të ankesës | Kontestim konkursi | Kërkesa nga Mardhënia e Punës | Transferim | Kompensim material | Masë disiplinore | Ndërpreje e marrëdhënies së punës | Pezullim parandalues | Mos ekzekutim i vendimit të Komisionit të ankesave | Vlersim i Punës | Shkelje e të drejtës në pagë | Ulje në Pozitë | Ç'është e Avancimit në karrierë | Mos vazhdim i kontratës së punës | Kundër caktimit të Ushtruesit të detyrës | Gjithsejtë |
|--|---------------------------|--------------------------------------|-------------------|---------------------------|-------------------------|--|-----------------------------|---|------------------------|-------------------------------------|-----------------------|--|---|---|-------------------|
| Ministria e Infrastrukturës | 7 | 21 | 9 | 3 | | | 1 | 1 | | | | | | | 42 |
| Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës | 15 | | 2 | 2 | | 1 | | | | 1 | | | | | 21 |
| Ministria e Punëve të Jashtme | 11 | | 1 | 1 | | | | 2 | | | | 1 | | | 16 |
| Ministria e Financave | 4 | | 2 | 3 | 5 | | | | | 2 | | | | | 16 |
| Ministria e Tregtisë dhe Industrisë | 6 | 1 | 3 | | | 2 | | 3 | | | | | | | 15 |
| Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë | 7 | 1 | | 1 | | | 3 | | | 3 | | | | | 15 |
| Ministria e Punëve të Brendshme | 5 | | 1 | 2 | 1 | 2 | 3 | | | | | | | | 14 |
| Ministria e Shëndetësisë | 5 | 2 | 1 | 3 | 2 | 1 | | | | | | | | | 14 |
| Administrata Tatimore e Kosovës | 3 | | 6 | | 1 | 2 | | | | | | | | | 12 |
| Agjencia e Statistikave të Kosovës | 3 | 4 | 2 | | | | | | | | | | 1 | | 10 |

| | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|--|--|--|--|--|--|----|
| Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale | 3 | 3 | | 2 | | 1 | 1 | | | | | | | | | | 10 |
| Agjencia Kosovare e Privatizimit | 1 | | | 1 | | 3 | 1 | | 3 | | | | | | | | 9 |
| Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit | 6 | 1 | | 1 | | | | 1 | | | | | | | | | 9 |
| Policia e Kosovës | 1 | | 1 | | 3 | 2 | 1 | | | | | | | | | | 8 |
| Ministria e Diasporës | 1 | 3 | | | 3 | | | | | | | | | | | | 7 |
| Ministria e Administratës Publike | 4 | 2 | | | | | | | | 1 | | | | | | | 7 |
| Shërbimi Korrektues i Kosovës | 4 | 1 | | | 1 | | 1 | | | | | | | | | | 7 |
| Gjykata Themelore Gjilan | 4 | | 2 | | | | | | | | | | | | | | 6 |
| Gjykata Themelore Prishtinë | 6 | | | | | | | | | | | | | | | | 6 |
| Prokuroria e Shtetit | 3 | 1 | | 2 | | | | | | | | | | | | | 6 |
| Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore | | | | 1 | 1 | 1 | | | 2 | | | | | | | | 5 |
| Dogana e Kosovës | | | | | 1 | 3 | | | 1 | | | | | | | | 5 |
| Gjykata Themelore Ferizaj | 3 | | | | 1 | | 1 | | | | | | | | | | 5 |
| Këshilli Prokurorial i Kosovës | 3 | | | | 1 | 1 | | | | | | | | | | | 5 |
| Ministria e Zhvillimit Ekonomik | | | 1 | 1 | 2 | | | | | | | | | | | | 4 |

| | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|--|---|---|---|---|---|--|---|---|---|---|--|---|
| Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor | 4 | | | | | | | | | | | | | 4 |
| Universiteti i Gjakovës | 4 | | | | | | | | | | | | | 4 |
| Gjykata Supreme e Kosovës | 1 | | | 1 | | 1 | | | | | 1 | | | 4 |
| Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale | 2 | | | 1 | | | 1 | | | | | | | 4 |
| Agjencia Pyjore e Kosovës | | | | | 2 | 1 | | | | | | | | 3 |
| Universiteti i Prishtinës | | | | 1 | | | 1 | | 1 | | | | | 3 |
| Biblioteka Kombëtare e Kosovës | | | 3 | | | | | | | | | | | 3 |
| Autoriteti Kosovar i Konkurrencës | 3 | | | | | | | | | | | | | 3 |
| Kuvendi i Republikës së Kosovës | 2 | | | | | 1 | | | | | | | | 3 |
| Universiteti i Pejës | 2 | | | | | | | | 1 | | | | | 3 |
| Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal | 1 | | | | | | 1 | | | | | | | 2 |
| Organi Shqyrtues i Prokurimit | | | | | 2 | | | | | | | | | 2 |
| Këshilli i Pavarur Mbikëqyres për Shërbimin Civil | | | | | | | | | | 1 | | 1 | | 2 |
| Agjencioni Kadastral i Kosovës | | | | 1 | | | | | | | 1 | | | 2 |
| Akademia e Kosovës për Siguri Publike | | | | 2 | | | | | | | | | | 2 |
| Gjykata e Apelit Prishtinë | 2 | | | | | | | | | | | | | 2 |

| | | | | | | | | | | | | | | | |
|--|------------|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|----------|----------|----------|----------|----------|----------|------------|
| Agjencia e Shërbimeve për Navigacion Ajror | | 1 | | | | | | | | | | | | | 1 |
| Agjencioni për Ndihmë Juridike Falas | | | 1 | | | | | | | | | | | | 1 |
| Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale | | | | | | 1 | | | | | | | | | 1 |
| Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës | | | | | | | | | 1 | | | | | | 1 |
| Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave | | | | | | | | | | | | 1 | | | 1 |
| Gjykata Themelore Prizeren | | | | 1 | | | | | | | | | | | 1 |
| Gjykata Themelore Pejë | 1 | | | | | | | | | | | | | | 1 |
| Qendra Klinike Universitare | | | | | | | | | | 1 | | | | | 1 |
| Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare Ferizaj | | | | | | 1 | | | | | | | | | 1 |
| Universiteti i Mitrovicës | | | | 1 | | | | | | | | | | | 1 |
| Gjykata Themelore Podujevë | 1 | | | | | | | | | | | | | | 1 |
| Gjykata Themelore Gjakovë | | | | | | | | | | | | 1 | | | 1 |
| Gjithsejt: | 135 | 43 | 36 | 32 | 27 | 25 | 14 | 10 | 7 | 7 | 5 | 5 | 3 | 1 | 350 |

Tabela nr.6 paraqet ankesat e pranuar kundër vendimeve të institucioneve të administratës qendrore, sipas objektit të ankesave

6.2. Ankesat kundër vendimeve të institucioneve të administratës lokale

Këshilli gjatë periudhes raportuese ka pranuar 246 ankesa kundër vendimeve të institucioneve të administratës lokale, të cilat pasqyrohen si në vijim:

| Nr. | Institucionet e administratës lokale | Numri i ankesave | Përqindja |
|-----|--------------------------------------|------------------|-----------|
| 1 | Komuna e Prishtinës | 49 | 8.22% |
| 2 | Komuna e Gjakovës | 20 | 3.35% |
| 3 | Komuna e Mitrovicës | 18 | 3.02% |
| 4 | Komuna e Prizrenit | 16 | 2.7% |
| 5 | Komuna e Gjilanit | 15 | 2.53% |
| 6 | Komuna e Ferizajt | 15 | 2.53% |
| 7 | Komuna e Parteshit | 14 | 2.35% |
| 8 | Komuna e Zubin Potokut | 11 | 1.84% |
| 9 | Komuna e Lipjanit | 10 | 1.7% |
| 10 | Komuna e Klllokotit | 9 | 1.51% |
| 11 | Komuna e Pejës | 9 | 1.51% |
| 12 | Komuna e Obiliqit | 7 | 1.17% |
| 13 | Komuna e Leposaviqit | 6 | 1.00% |
| 14 | Komuna e Kamenicës | 6 | 1.00% |
| 15 | Komuna e Vitisë | 6 | 1.00% |
| 16 | Komuna e Kaçanikut | 6 | 1.00% |
| 17 | Komuna e Suharekës | 5 | 0.84% |
| 18 | Komuna e Shtimes | 4 | 0.67% |
| 19 | Komuna e Malishevës | 4 | 0.67% |
| 20 | Komuna e Klinës | 3 | 0.50% |
| 21 | Komuna e Vushtrrisë | 3 | 0.50% |
| 22 | Komuna Skenderajt | 2 | 0.33% |
| 23 | Komuna e Drenasit | 2 | 0.33% |
| 24 | Komuna e Podujevës | 2 | 0.33% |
| 25 | Komuna e Deçanit | 2 | 0.33% |
| 26 | Komuna e Rahovecit | 1 | 0.17% |
| 27 | Komuna e Graçanicës | 1 | 0.17% |
| | Gjithsejt: | 246 | 41.27% |

Tabela nr.7 Paraqet të dhënat për numrin dhe përqindjen e ankesave të arritura në Këshill, gjatë vitit 2016, kundër vendimeve të institucioneve të administratës lokale

| Ankesat e pranuar kundër vendimeve të institucioneve të administratës lokale | Kontestim konkursi | Kompensim material | Ndërprerje e marrëdhënies së punës | Transferim | Masë disiplinore | Pezullim Parandalues | Vlerësim i punës | Shkelje e të drejtës në pagë | Kërkesa nga mardhënia e punës | Mos vazhdim i kontratës së punës | Mos ekzekutim i vendimit të | Gjithsejtë |
|--|--------------------|--------------------|------------------------------------|------------|------------------|----------------------|------------------|------------------------------|-------------------------------|----------------------------------|-----------------------------|------------|
| Komuna e Prishtinës | 11 | 8 | 15 | 10 | 3 | 1 | | | | 1 | | 49 |
| Komuna e Gjakovës | 5 | 3 | 2 | | 1 | 4 | | | 3 | 2 | | 20 |
| Komuna e Mitrovicës | 10 | 5 | | | 2 | | | | 1 | | | 18 |
| Komuna e Prizrenit | 7 | | 1 | 2 | | | | 6 | | | | 16 |
| Komuna e Gjilanit | 5 | 2 | | | | 8 | | | | | | 15 |
| Komuna e Ferizajt | 1 | 8 | 1 | | 5 | | | | | | | 15 |
| Komuna e Parteshit | 4 | | | | | | 10 | | | | | 14 |
| Komuna e Zubin Potokut | | 11 | | | | | | | | | | 11 |
| Komuna e Lipjanit | 5 | | | 2 | | | | 2 | | 1 | | 10 |
| Komuna e Klllokotit | | | 4 | 1 | 3 | | 1 | | | | | 9 |
| Komuna e Pejës | 1 | 1 | 1 | 1 | | 2 | | 2 | 1 | | | 9 |
| Komuna e Obiliqit | 3 | 1 | | | | | | 2 | | | 1 | 7 |
| Komuna e Leposaviqit | | | 6 | | | | | | | | | 6 |
| Komuna e Kamenicës | 4 | | | | 1 | | | | 1 | | | 6 |
| Komuna e Vitisë | 2 | 2 | 1 | | | | 1 | | | | | 6 |
| Komuna e Kaçanikut | 2 | 1 | | | 1 | 2 | | | | | | 6 |
| Komuna e Suharekës | 3 | | | 1 | | | | | 1 | | | 5 |
| Komuna e Shtimes | 1 | | 3 | | | | | | | | | 4 |
| Komuna e Malishevës | 1 | 1 | 2 | | | | | | | | | 4 |
| Komuna e Klinës | 1 | | | | | | | 1 | | 1 | | 3 |
| Komuna e Vushtrrisë | 2 | 1 | | | | | | | | | | 3 |
| Komuna Skenderajt | 1 | 1 | | | | | | | | | | 2 |
| Komuna e Drenasit | | 2 | | | | | | | | | | 2 |
| Komuna e Podujevës | | 1 | 1 | | | | | | | | | 2 |

| | | | | | | | | | | | | |
|---------------------|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|----------|----------|----------|------------|
| Komuna e Deçanit | 1 | | | | | | | 1 | | | | 2 |
| Komuna e Rahovecit | | | | | | | | | 1 | | | 1 |
| Komuna e Graçanicës | | | | | 1 | | | | | | | 1 |
| Gjithsejt: | 70 | 48 | 37 | 17 | 17 | 17 | 14 | 12 | 8 | 5 | 1 | 246 |

Tabela nr.8 paraqet ankesat e pranuar kundër vendimeve të institucioneve të administratës lokale sipas objektit të ankesave

7. NDARJA E ANKESAVE SIPAS MËNYRËS SË VENDOSJES

Këshilli, gjatë vitit 2016, ka shqyrtuar dhe ka vendosur për gjithsej 571 ankesa, si në vijim:

7.1 Të aprovuara

Janë ankesat e parashtruara nga ankuesit, që në bazë të provave dhe fakteve, Këshilli i ka aprovuar dhe ka anuluar vendimet e organeve të punësimit, duke i obliguar organet e punësimit për zbatimin e vendimeve të Këshillit në afatin e përcaktuar ligjor.

Këshilli gjatë periudhës raportuese ka aprovuar **(114)** ankesa.

7.2 Pjesërisht të aprovuara

Janë ankesat e parashtruara nga ankuesit të cilat kanë dy e më shumë pretendime ankimore dhe për të cilat Këshilli në bazë të provave dhe fakteve të ofruara nga ankuesit dhe nga organet e punësimit ka vendosur për aprovimin e pjesërishtëm të ankesës.

Këshilli gjatë periudhës raportuese ka aprovuar pjesërisht **(11)** ankesa.

7.3 Të refuzuara

Janë ankesat e parashtruara nga ankuesit, të cilat Këshilli i ka refuzuar si të pabazuara në bazë të provave dhe fakteve të paraqitura nga ankuesit dhe organet e punësimit, duke lënë në fuqi vendimet e organeve të punësimit.

Këshilli gjatë periudhës raportuese ka refuzuar **(188)** ankesa.

7.4 Të hedhura poshtë si të palejuara

Janë ankesat e parashtruara nga ankuesit, të cilat Këshilli i ka hedhë poshtë si të palejuara sepse nuk janë shterrur mjetet e brendshme të ankimit, janë parashtruar jashtë afatit të përcaktuar ligjor për ankimim, apo janë parashtruar nga personat që në bazë të ligjit nuk konsiderohen palë në procedurë. Këshilli gjatë periudhës raportuese ka hedh poshtë si të palejuara **(122)** ankesa.

7.5 Të shpallura jo-kompetent

Janë ankesat e parashtruara nga ankuesit për të cilat Këshilli ka vendosur që të shpallet jo-kompetent, për shkak se ankesat janë parashtruar nga personat të cilët nuk e kanë statusin e nëpunësit civil ose nuk janë kandidat për pranim në shërbimin civil.

Këshilli gjatë periudhës raportuese është shpall jo kompetent për **(36)** ankesa.

7.6 Detyrimi i organit administrativ për të nxjerr aktin administrativ

Janë vendime me të cilat Këshilli i detyron organet e punësimit, respektivisht komisionet përkatëse për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave për të vendosur për ankesën e ankuesit, në rastet kur nuk ka vendosur për ankesën e ankuesit ashtu siç është përcaktuar me dispozitat e Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Këshilli gjatë periudhës raportuese ka nxjerr vendime për detyrimin e organeve të punësimit për të vendosur, për **(59)** ankesa.

7.7 Kthimi në rishqyrtim

Janë vendime me të cilat, Këshilli ka vendos për kthimin e lëndës në rishqyrtim tek organet e punësimit për të gjitha rastet kur në bazë të provave dhe fakteve të ofruara nga ankuesit dhe nga organet e punësimit, Këshilli ka konstatuar se nëse lënda kthehet në rishqyrtim tek organi i punësimit do të evitohen gabimet të cilat nuk konsiderohen si shkelje të rënda procedurale. Këshilli gjatë periudhës raportuese ka vendosur për kthimin e lëndës në rishqyrtim për **(25)** ankesa.

7.8 Përfundim i procedimit administrativ


Janë vendime të cilat Këshilli i nxjerr për të gjitha rastet kur ankuesit i tërheqin ankesat ose kur Këshilli konstaton se objekti për të cilin kishte filluar procedimi ose qëllimi i vendimit është bërë i pamundur.

Këshilli gjatë periudhës raportuese ka vendosur për përfundimin e procedimit administrativ për **(16)** ankesa.

Në tabelën në vijim paraqitet në mënyrë tabelare, mënyra e vendosjes nga Këshilli për 571 ankesa, numri i ankesave të vendosura si dhe përqindja në krahasim me numrin e përgjithshëm të ankesave të vendosura.

| Mënyra e vendosjes | Numri i ankesave | Përqindja |
|--------------------------------------|------------------|-------------|
| Të refuzuara | 188 | 32.93% |
| Të hedhura poshtë si të palejuara | 122 | 21.36% |
| Të aprovuara | 114 | 19.97 % |
| Detyrim për vendosje | 59 | 10.34% |
| Shpallja jo kompetent | 36 | 6.31% |
| Kthimi në rishqyrtim | 25 | 4.38% |
| Përfundim i procedimit administrativ | 16 | 2.81% |
| Të aprovuara pjesërisht | 11 | 1.93% |
| Gjithsejtë | 571 | 100% |

Tabela nr. 9 paraqet mënyrën e vendosjes së ankesave nga Këshilli, numrin e ankesave sipas mënyrës së vendosjes dhe përqindjen në krahasim me numrin e përgjithshëm të ankesave



Diagrami nr. 5 paraqet të dhënat e tabelës nr.9

8. FORMAT E VENDOSJES KUNDËR VENDIMEVE TË INSTITUCIONEVE

Në këtë pjesë të raportit, paraqiten të dhënat për formën e vendosjes nga Këshilli, lidhur me ankesat e parashtruara kundër vendimeve të institucioneve të administratës qendrore dhe lokale.

8.1 Format e vendosjes kundër vendimeve të institucioneve të administratës qendrore

Këshilli, gjatë periudhës raportuese ka vendosur për **348** ankesa të parashtruara kundër vendimeve të institucioneve të administratës qendrore, gjegjësisht për **308** ankesa të vitit 2016, dhe për **40** ankesa të bartura nga viti 2015 në vitin 2016.

| Institucionet e Administratës Qendrore | Të aprovuara | Të refuzuara | Pjesërisht të aprovuara | Të hedhura poshtë si të palejuara | Shpallja jo kompetent | Kthimi në rishqyrtim | Përfundim i procedimit administrativ | Detyrimi i organit administrativ për të nxjerr aktin administrativ | Numri i ankesave të shqyrtuara |
|--|--------------|--------------|-------------------------|-----------------------------------|-----------------------|----------------------|--------------------------------------|--|--------------------------------|
| Ministria e Infrastrukturës | 5 | 7 | | 5 | | 1 | 2 | 17 | 37 |
| Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës | 1 | 14 | | 1 | 5 | | | 1 | 22 |
| Ministria e Punëve të Jashtme | 2 | 4 | | 3 | | 2 | 1 | 5 | 17 |
| Administrata Tatimore e Kosovës | 9 | 2 | | 2 | 2 | 1 | | | 16 |
| Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë | 2 | 4 | | 5 | | | 2 | 3 | 16 |
| Ministria e Financave | 4 | 2 | | 4 | | 2 | | 4 | 16 |
| Ministria e Tregtisë dhe Industrisë | 3 | 5 | 1 | 3 | | | 1 | 2 | 15 |
| Ministria e Shëndetësisë | 2 | 4 | | 2 | 2 | | 2 | 3 | 15 |
| Ministria e Punëve të Brendshme | 1 | 9 | | 1 | | 2 | | | 13 |
| Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale | 2 | 4 | | 3 | | | | 2 | 11 |
| Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit | 1 | 7 | | 3 | | | | | 11 |
| Agjencia e Statistikave të Kosovës | 3 | 3 | | 1 | 3 | | | | 10 |
| Agjencia Kosovare e Privatizimit | 1 | 3 | | 4 | | | | | 8 |
| Ministria e Diasporës | 1 | 1 | 1 | 2 | | 1 | 1 | | 7 |
| Prokuroria e Shtetit | | 2 | | 3 | | 1 | | | 6 |
| Policia e Kosovës | 2 | 1 | | | | 2 | 1 | | 6 |
| Ministria e Administratës Publike | 1 | 3 | | | | | | 1 | 5 |

| | | | | | | | | |
|--|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Dogana e Kosovës | 4 | | | 1 | | | | 5 |
| Ministria e Zhvillimit Ekonomik | 1 | | | 2 | 1 | 1 | | 5 |
| Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor | | 2 | | | | | 3 | 5 |
| Gjykata themelore Prishtinë | 4 | | | 1 | | | | 5 |
| Universiteti i Gjakovës | | 2 | | 1 | 1 | | | 5 |
| Shërbimi Korrektues i Kosovës | 1 | | | 3 | 1 | | | 5 |
| Komisioni për Miniera dhe Minerale | | 2 | | 1 | | 1 | | 4 |
| Gjykata themelore Gjilan | | 3 | | 1 | | | | 4 |
| Gjykata themelore Ferizaj | | 2 | | 2 | | | | 4 |
| Këshilli prokurorial i Kosovës | 1 | 2 | | | 1 | | | 4 |
| Gjykata Supreme e Kosovës | 1 | 1 | | 2 | | | | 4 |
| Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore | 1 | 2 | | | | 1 | | 4 |
| Universiteti i Prishtinës | | | | 2 | | | 1 | 3 |
| Universiteti i Prizerenit | 2 | | | 1 | | | | 3 |
| Kuvendi i Kosovës | 1 | 2 | | | | | | 3 |
| Autoriteti Kosovar i Konkurrencës | 2 | | | | | | 1 | 3 |
| Biblioteka Kombëtare e Kosovës | | | 3 | | | | | 3 |
| Agjencia Pyjore e Kosovës | 3 | | | | | | | 3 |
| Zyra e Auditorit të Përgjithshëm | | 1 | | | 1 | | | 2 |
| Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal | | 2 | | | | | | 2 |
| Zyra e Kryeministrit | | 1 | | 1 | | | | 2 |
| Ministria e FSK-së | | 1 | | 1 | | | | 2 |
| Teatri Kombëtar i Kosovës | | 2 | | | | | | 2 |
| Universiteti i Pejës | | | | 2 | | | | 2 |
| Zyra e Rregullatorit për Energji | | | | | 2 | | | 2 |
| Akademia e Kosovës për Siguri Publike | | | 1 | | | 1 | | 2 |
| Agjencioni Kadastral i Kosovës | 1 | | | 1 | | | | 2 |
| Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil | | 1 | | | | | 1 | 2 |
| Agjencia Kundër Korrupsionit | | 1 | | 1 | | | | 2 |
| Gjykata Themelore Mitrovicë | | | | 2 | | | | 2 |
| Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës | | | | 1 | | | | 1 |
| Qendra Klinike Universitare | | | | | 1 | | | 1 |
| Organi Shqyrtues i Prokurimit | | | | 1 | | | | 1 |
| Ministria për Komunitete dhe Kthim | | | | 1 | | | | 1 |
| Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural | | 1 | | | | | | 1 |
| Ministria e Drejtësisë | 1 | | | | | | | 1 |
| Zyra e Rregullatorit për Ujësjetës dhe Kanalizim | | 1 | | | | | | 1 |

| | | | | | | | | | |
|--|-----------|------------|----------|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|------------|
| Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare Prishtinë | | | | | 1 | | | | 1 |
| Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare Ferizaj | 1 | | | | | | | | 1 |
| Gjykata Themelore Prizeren | | | 1 | | | | | | 1 |
| Agjencia e Shërbimeve për Navigacion Ajror | | | | | | | 1 | | 1 |
| Agjencia e Akreditimit të Kosovës | | 1 | | | | | | | 1 |
| Universiteti i Mitrovicës | | | 1 | | | | | | 1 |
| Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale | 1 | | | | | | | | 1 |
| Gjykata Themelore Gjakovë | | | | | | 1 | | | 1 |
| Gjykata Themelore Podujevë | 1 | | | | | | | | 1 |
| Gjykata Themelore Pejë | | | | | 1 | | | | 1 |
| Agjencia për Ndhimë Juridike Falas | | 1 | | | | | | | 1 |
| Agjencia për Mbrojtjen nga Rrezatimi dhe Siguri Bërthamore | | | | 1 | | | | | 1 |
| Komisioni Qendror i Zgjedhjeve | | | | 1 | | | | | 1 |
| Agjencia Kosovare e Pronës | | 1 | | | | | | | 1 |
| Gjithsejt: | 66 | 107 | 8 | 72 | 22 | 17 | 14 | 42 | 348 |

Tabela nr.10 paraqet format e vendosjes për ankesat e shqyrtuara dhe të vendosura gjatë vitit 2016 kundër vendimeve të institucioneve të administratës qendrore

8.2 Format e vendosjes kundër vendimeve të institucioneve të administratës lokale

Këshilli, gjatë periudhës raportuese ka vendosur për 223 ankesa të parashtruara kundër vendimeve të institucioneve të administratës lokale, gjegjësisht për 205 ankesa të vitit 2016, dhe për 18 ankesa të bartura nga viti 2015 në vitin 2016.

| Institucionet e Administratës Lokale | Të aprovuara | Të refuzuara | Pjesërisht të aprovuara | Të hedhura poshtë si të palejuara | Shpallja jo kompetent | Kthimi në rishqyrtim | Përfundim i procedimit administrativ | Detyrimi i organit administrativ për të nxjerr aktin administrativ | Numri i ankesave të shqyrtuara |
|--------------------------------------|--------------|--------------|-------------------------|-----------------------------------|-----------------------|----------------------|--------------------------------------|--|--------------------------------|
| Komuna e Prishtinës | 17 | 6 | | 11 | 2 | | | 11 | 47 |
| Komuna e Gjakovës | 2 | 11 | | 2 | 2 | | 1 | | 18 |
| Komuna e Prizrenit | 3 | 8 | | 1 | 2 | | | 3 | 17 |
| Komuna e Mitrovicës | 1 | 9 | | 4 | | | | 2 | 16 |
| Komuna e Parteshit | 5 | 4 | | | | 5 | | | 14 |
| Komuna e Ferizajit | 3 | 2 | 1 | 5 | 3 | | | | 14 |
| Komuna e Gjilanit | 2 | 5 | 1 | 1 | | 1 | | | 10 |
| Komuna e Klllokotit | 2 | 4 | 3 | 1 | | | | | 10 |
| Komuna e Lipjanit | 2 | 2 | 1 | 2 | | | | 1 | 8 |
| Komuna e Obiliqit | 1 | 4 | | 2 | | | | | 7 |
| Komuna e Suharekës | 1 | 4 | | 2 | | | | | 7 |
| Komuna e Kamenicës | 2 | 4 | | 1 | | | | | 7 |
| Komuna e Kaçanikut | | 6 | | | | | | | 6 |
| Komuna e Leposaviqit | | | | 6 | | | | | 6 |
| Komuna e Malishevës | 1 | 3 | | 1 | | | | | 5 |
| Komuna e Vitisë | 2 | 1 | | 2 | | | | | 5 |
| Komuna e Rahovecit | | | | 4 | | | | | 4 |
| Komuna e Shtimes | 2 | 1 | | | | 1 | | | 4 |
| Komuna e Pejës | | | | | 2 | 1 | | | 3 |
| Komuna e Klinës | | 2 | | | | | | | 2 |
| Komuna e Graçanicës | 1 | 1 | | | | | | | 2 |
| Komuna e Deçanit | | 1 | | | | | 1 | | 2 |
| Komuna e Drenasit | | 1 | | | 1 | | | | 2 |
| Komuna e Podujevës | | 1 | | 1 | | | | | 2 |
| Komuna e Vushtrisë | | 1 | | 1 | | | | | 2 |

| | | | | | | | | | |
|------------------------|----|----|---|----|----|---|---|----|-----|
| Komuna e Zubin Potokut | | | | | 2 | | | | 2 |
| Komuna e Skenderajt | 1 | | | | | | | | 1 |
| Gjithsejt: | 48 | 81 | 6 | 47 | 14 | 8 | 2 | 17 | 223 |

Tabela nr.11 paraqet format e vendosjes për ankesat e shqyrtuara dhe te vendosura gjate vitit 2016 kundër vendimeve të institucioneve të administratës lokale

9. ZBATIMI I VENDIMEVE TË KËSHILLIT NGA ORGANET E PUNËSIMIT

Në pajtim me dispozitat e nenit 13 të Ligjit Nr.03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, organet e punësimit që kanë të punësuar nëpunës civil janë të obliguara për zbatimin e vendimeve të Këshillit.

Vendimet e Këshillit janë vendime administrative të formës së prerë dhe duhet të zbatohen nga zyrtari i nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që ka nxjerrë vendimin e parë ndaj palës.

Moszbatimi i vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i institucionit paraqet shkelje të rëndë të detyrave të punës sipas Ligjit për Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës.


Organet e punësimit për vitin 2016, kanë pasur obligim ligjor për të zbatuar **209** vendime të Këshillit, gjegjësisht:

- **114** vendime me të cilat janë aprovuar ankesat,
- **11** vendime me të cilat janë aprovuar pjesërisht ankesat,
- **59** vendime me të cilat organet e punësimit janë obliguar që të nxjerrin aktin administrativ dhe
- **25** vendime me të cilat organet e punësimit janë obliguar që të rishqyrtojnë vendimet e tyre.

Përkundër faktit që vendimet e Këshillit janë të vendime të formës së prerë në procedurë administrative, nga njoftimet që Këshilli ka pranuar nga organet e punësimit dhe ankuesit rezulton që organet e punësimit kanë zbatuar **181** vendime, ndërsa nuk kanë zbatuar **28** vendime të Këshillit.

| Vendimet e Këshillit për ankesat | Numri i vendimeve | Vendimet e zbatuara | Vendimet e pa zbatuara | Numri i vendimeve të pezulluara me vendim të Gjykatës |
|----------------------------------|-------------------|---------------------|------------------------|---|
| Të aprovuara | 114 | 92 | 22 | 0 |
| Detyrim për vendosje | 59 | 55 | 4 | |
| Kthimi në rishqyrtim | 25 | 24 | 1 | |
| Pjesërisht të aprovuara | 11 | 10 | 1 | |
| Gjithsejtë: | 209 | 181 | 28 | 0 |

Tabela nr. 12 paraqet numrin e ankesave, vendimet e zbatuara, vendimet e pazbatuara si dhe vendimet e pezulluara me vendim të gjykatës



Diagrami nr.6 paraqet të dhënat e tabelës nr.12

Në tabelën në vijim, paraqiten të dhënat për institucionet e administratës qendrore që nuk i kanë zbatuar vendimet e Këshillit si dhe numrin e vendimeve të pazbatuara.

| Nr. | Institucionet e administratës qendrore dhe lokale | Numri i vendimeve të pazbatuara | Numri referues i vendimit | Personi përgjegjës për zbatim |
|-----|---|---------------------------------|--|-------------------------------------|
| 1 | Administrata Tatimore e Kosovës | 4 | A 02/551/2015 A 02/570/2015 A 02/218/2016 A 02/428/2016 | Drejtori i Përgjithshëm i ATK |
| 2 | Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë | 2 | A 02/125/2016 A 02/409/2016 | Sekretari i Përgjithshëm i MASHT-it |
| 3 | Ministria e Punëve të Jashtme | 2 | A 02/313/2016 A 02/455/2016 | Sekretari i Përgjithshëm i MPJ-së |
| 4 | Ministria e Infrastrukturës | 1 | A 02/309/2016 | Sekretari i Përgjithshëm i MI |
| 5 | Ministria e Tregtisë dhe Industrisë | 1 | A 02/577/2015 | Ministrja e MTI-së |
| 6 | Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale | 1 | A 02/62/2016 | Sekretari i Përgjithshëm i MPMS-së |
| 7 | Ministria e Drejtësisë | 1 | A 02/263/2016 | Kryeshefi i Agjencisë së APSK-së |
| 8 | Ministria e Financave | 1 | A 02/267/2016 | Sekretari i Përgjithshëm i MF-së |
| 9 | Policia e Kosovës | 1 | A 02/06/2016 | Drejtori i Përgjithshëm i PK-së |
| 10 | Ministria e Diasporës | 1 | A 02/285/2016 | Sekretari i Përgjithshëm i MD-së |
| 12 | Autoriteti Kosovar i Konkurences | 1 | A 02/469/2016 | Sekretari |
| | Gjithsejt: | 16 | | |

Tabela nr.13 paraqet institucionet e administratës publike dhe ZKA që nuk kanë zbatuar vendimet e Këshillit si dhe numrin e vendimeve të pazbatuara.

Në tabelën në vijim, paraqiten të dhënat për institucionet e administratës lokale që nuk i kanë zbatuar vendimet e Këshillit si dhe numrin e vendimeve të pazbatuara.

| | Institucionet e administratës qendrore dhe lokale | Numri i vendimeve të pazbatuara | Numri referues i vendimit | Personi përgjegjës për zbatim |
|---|--|--|---|--------------------------------------|
| 1 | Komuna e Prishtinës | 11 | A 02/392/2016 A 02/463/2016 A 02/465/2016 A 02/466/2016 A 02/470/2016 A 02/475/2016 A 02/515/2016 A 02/523/2016 A 02/550/2016 A 02/564/2015 A 02/603/2015 | Kryetari i Komunës |
| 2 | Komuna e Ferizajt (QKMF) | 1 | A 02/49/2016 | Kryetari i Komunës |
| | Gjithsejt: | 12 | | |

10. FUNKSIONI I MBIKËQYRJES SË ZBATIMIT TË RREGULLAVE DHE PARIMEVE TË LEGJISLACIONIT PËR SHËRBIMIN CIVIL

Këshilli gjatë periudhës raportuese ka ushtruar funksionin e mbikëqyrjes në bazë të nenit 10 paragrafit 3 dhe nenit 17 të Ligjit Nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke mbikëqyrur zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil për dosjet e personelit, procedurat e pranimit në shërbimin civil, zëvendësimin e kontratave të nëpunësve civil, pushimet në shërbimin civil, procedurat e avancimit në karrierë të nëpunësve civilë, procedurat e transferimit të nëpunësve civilë, vlerësimin e rezultateve të punës për nëpunësit civilë, klasifikimin dhe sistematizimin e vendeve të punës në shërbimin civil, procedurat e ndërprerjes, pezullimit dhe përfundimit të marrëdhënies së punës; komisionet disiplinore dhe procedurat disiplinore si dhe për komisionet për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave dhe procedurat e ankesave në kuadër të institucioneve të administratës publike qendrore dhe lokale.

Këshilli, me vendimin me numër 297/2016 të datës 27.01.2016, ka aprovuar Planin e Monitorimit për vitin 2016.

Në bazë të Planit të Monitorimit, Këshilli ka realizuar pesëdhjete e shtatë (57) vizita monitoruese të mbikëqyrjes së zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil në institucionet e administratës qendrore dhe lokale si dhe në 5 ambasada si në vijim: Ambasada e Republikës së Kosovës në Suedi, Itali, Slloveni, Kroaci dhe Maqedoni. Të gjeturat dhe rekomandimet e evidentuara gjatë mbikëqyrjes së zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil për ambasadat janë përfshirë në kuadër të Raportit të Mbikëqyrjes për Ministrinë e Punëve të Jashtme.

Në raportet e mbikëqyrjes së zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil për institucione të nivelit qendror dhe lokal, Këshilli, ka evidentuar dhe ka konstatuar **337** shkelje të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, dhe për shkeljet e evidentuara ka dhënë **245** rekomandime për zyrtarët përgjegjës të institucioneve të monitoruara.

| Numri rendor | Institucionet e administratës qendrore dhe lokale të monitoruara | Numrit i të gjeturave | Numri i rekomandimeve |
|--------------|--|-----------------------|-----------------------|
| 1 | Agjencia Kosovare e Privatizimit | 16 | 8 |
| 2 | Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë | 15 | 7 |
| 3 | Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik | 13 | 6 |
| 4 | Ministria e Shëndetësisë | 12 | 7 |
| 5 | Komuna e Gjakovës | 11 | 6 |
| 6 | Ministria e Punëve të Jashtme | 11 | 8 |
| 7 | Ministria e Zhvillimit Ekonomik | 10 | 6 |
| 8 | Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale | 9 | 6 |
| 9 | Administrata Tatimore e Kosovës | 9 | 8 |
| 10 | Universiteti i Prishtinës | 9 | 7 |

| | | | |
|----|--|---|---|
| 11 | Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit | 8 | 4 |
| 12 | Komuna e Lipjanit | 8 | 6 |
| 13 | Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor | 8 | 5 |
| 14 | Ministria e Infrastrukturës | 8 | 6 |
| 15 | Komuna e Fushë Kosovës | 7 | 5 |
| 16 | Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës | 7 | 4 |
| 17 | Komuna e Skenderajt | 7 | 6 |
| 18 | Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore | 7 | 6 |
| 19 | Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës | 7 | 4 |
| 20 | Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural | 7 | 4 |
| 21 | Komuna e Pejës | 7 | 6 |
| 22 | Agjencia Pyjore e Kosovës | 6 | 5 |
| 23 | Komuna e Obiliqit | 6 | 6 |
| 24 | Ministria e Financave | 6 | 3 |
| 25 | Ministria e Punëve të Brendshme | 6 | 5 |
| 26 | Komuna e Podujevës | 6 | 5 |
| 27 | Komuna e Prizrenit | 6 | 5 |
| 28 | Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë | 5 | 4 |
| 29 | Komuna e Mamushës | 5 | 4 |
| 30 | Ministria për Komunitete dhe Kthim | 5 | 3 |
| 31 | Komuna e Parteshit | 5 | 4 |
| 32 | Organi Shqyrtues i Prokurimit | 5 | 5 |
| 33 | Komuna e Hanit të Elezit | 5 | 4 |
| 34 | Komuna e Kamenicës | 4 | 4 |
| 35 | Universiteti i Gjakovës | 4 | 3 |
| 36 | Komuna e Suharekës | 4 | 3 |
| 37 | Ministria e Tregtisë dhe Industrisë | 4 | 4 |
| 38 | Autoriteti Kosovar i Konkurrencës | 4 | 4 |
| 39 | Këshilli Prokurorial i Kosovës | 4 | 3 |
| 40 | Ministria e Drejtësisë | 4 | 4 |
| 41 | Instituti i Kosovës për Administratë Publike | 4 | 4 |
| 42 | Komuna e Kaçanikut | 4 | 4 |
| 43 | Zyra e Auditorit të Përgjithshëm | 4 | 4 |
| 44 | Ministria e Integritimit Evropian | 3 | 3 |
| 45 | Agjencia e Statistikave të Kosovës | 3 | 2 |
| 46 | Ministra e Administrimit të Pushtetit Lokal | 3 | 2 |
| 47 | Komuna e Gjilanit | 3 | 3 |
| 48 | Akademia e Kosovës për Siguri Publike | 3 | 3 |
| 49 | Zyra e Presidencës së Kosovës | 3 | 2 |
| 50 | Agjencia e Kosovës Kundër Korrupsionit | 3 | 3 |

| | | | |
|--------------------------|---|------------|------------|
| 51 | Kuvendi i Republikës së Kosovës | 3 | 2 |
| 52 | Komuna e Ferizajt | 3 | 3 |
| 53 | Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale | 3 | 3 |
| 54 | Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës | 2 | 1 |
| 55 | Komuna e Mitrovicës | 2 | 2 |
| 56 | Zyra e Kryeministrit | 1 | 1 |
| 57 | Komuna e Prishtinës (Raporti nuk është përgatitur për shkak se Komuna e Prishtinës e ka vonuar kompletimin e dërgimit të dëshmive lidhur me përgatitjen e dosjes së Monitorimit) | | |
| Gjithsejt vizita: | 57 | 337 | 245 |

Tabela nr.14 paraqet institucionet e administratës publike që janë monitoruar nga Këshilli si dhe numrin e e të gjeturave dhe rekoamdimeve

11. FUNKSIONI I VËZHGIMIT TË PROCEDURËS SË EMËRIMIT TË NËPUNËSVE CIVILË TË NIVELIT DREJTUES

Funksioni i vëzhgimit të procedurës së emërimit të nëpunësve civilë të nivelit drejtues është i përcaktuar me nenin 10 paragrafin 1.2 si dhe nenin 16 të Ligjit Nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Në pajtim me këto dispozita, Këshilli është kompetent për të vendosur nëse procedura e emërimit të nëpunësve civilë të nivelit drejtues është zhvilluar në pajtim me rregullat dhe parimet e përcaktuara me legjislacionin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Në pajtim me këtë dispozitë ligjore, organet e punësimit, janë të obliguara që të njoftojnë Këshillin, për të vëzhguar procesin e avancimit ose të rekrutimit të nëpunësve civilë të nivelit drejtues.

Këshilli gjatë vitit 2016 ka vëzhguar 248 procedura të vëzhgimit lidhur me procesin e emërimeve të nëpunësve civil të nivelit drejtues. Nga 248 pozita që janë vëzhguar, Këshilli ka aprovuar si të rregullta 104 procedura të rekrutimit.

Nga 248 procedura që janë vëzhguar, janë anuluar 144 procedura të rekrutimit për shkak të shkeljeve ligjore dhe procedurale.

Në vijim janë paraqitur në mënyrë tabelare, institucionet dhe numri i pozitave të nëpunësve civilë të nivelit drejtues për të cilat janë vëzhguar nga Këshilli, si dhe mënyrën e vendosjes për këto procedura.

Tabela nr. 14 Në këtë tabelë pasqyrohen procedurat e vëzhgimit për emërimin në pozitat e nivelit drejtues të cilat procedura të rekrutimit janë anuluar për shkak të shkeljeve ligjore dhe procedurale.

| Nr. rendor | Institucioini | Numri i procedurave të anuluar |
|------------|---|--------------------------------|
| 1 | Komuna e Prishtinës | 27 |
| 2 | Komuna e Gjakovës | 16 |
| 3 | Ministria e Punëve të Brendshme | 12 |
| 4 | Ministria e Shëndetësisë | 9 |
| 5 | Administrata Tatimore e Kosovës | 6 |
| 6 | Komuna e Istogut | 6 |
| 7 | Ministria e Arsimit, Shkëncës dhe Teknologjisë | 5 |
| 8 | Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit | 5 |
| 9 | Ministria e Infrastrukturës | 5 |
| 10 | Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale | 4 |
| 11 | Ministria e Tregtisë dhe Industrisë | 3 |
| 12 | Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor | 3 |
| 13 | Komuna e Prizrenit | 3 |
| 14 | Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës | 3 |

| | | |
|------------------|--|------------|
| 15 | Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa | 3 |
| 16 | Ministria e Punëve të Jashtme | 2 |
| 17 | Komuna e Obiliqit | 2 |
| 18 | Ministria e Administratës Publike | 2 |
| 19 | Agjencia Pyjore e Kosovës | 2 |
| 20 | Komuna e Gjilanit | 2 |
| 21 | Univeristeti i Prishtinës | 2 |
| 22 | Zyra e Kryeministrit | 2 |
| 23 | Ministria e Financave | 2 |
| 24 | Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal | 2 |
| 25 | Këshilli Prokurorial i Kosovës | 2 |
| 26 | Agjencia Kosovare e Pronës | 1 |
| 27 | Komuna e Ferizajt | 1 |
| 28 | Komuna e Skenderajt | 1 |
| 29 | Komuna e Lipjanit | 1 |
| 30 | Komuna e Klinës | 1 |
| 31 | Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës | 1 |
| 32 | Komuna e Kllkotit | 1 |
| 33 | Prokuroria e Shtetit | 1 |
| 34 | Komuna e Deçanit | 1 |
| 35 | Komuna e Vitisë | 1 |
| 36 | Autoriteti i Aviacionit Civil | 1 |
| 37 | Komisioni i Pavarur për Media | 1 |
| 38 | Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave | 1 |
| 39 | Ministria e Integritimit Evropian | 1 |
| Gjithsejt | | 144 |

Tabela nr. 15. Në këtë tabelë pasqyrohen procedurat e vëzhgimit për pozitat e nivelit drejtues të cilat procedura të rekrutimit janë aprovuar si të rregullta nga Këshilli

| Nr. rendor | Institucioni | Numri i procedurave të aprovuara |
|-------------------|--|---|
| 1 | Komuna e Prizrenit | 21 |
| 2 | Komuna e Gjakovës | 16 |
| 3 | Ministria e Administratës Publike | 7 |
| 4 | Ministria e Tregtisë dhe Industrisë | 6 |
| 5 | Ministria e Punëve të Brendshme | 5 |
| 6 | Komuna e Mitrovicës | 4 |
| 7 | Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovë | 4 |
| 8 | Ministria e Financave | 3 |
| 9 | Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal | 3 |
| 10 | Ministria e Shëndetësisë | 2 |
| 11 | Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë | 2 |
| 12 | Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit | 2 |

| | | |
|------------------|---|------------|
| 13 | Komuna e Kaçanikut | 2 |
| 14 | Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor | 2 |
| 15 | Komuna e Vushtrrisë | 2 |
| 16 | Ministria e Zhvillimit Ekonomik | 2 |
| 17 | Univeristeti i Pejës | 2 |
| 18 | Komuna e Lipjanit | 1 |
| 19 | Komuna e Prishtinës | 1 |
| 20 | Ministria e Punëve të Jashtme | 1 |
| 21 | Ministria e Infrastrukturës | 1 |
| 22 | Komuna e Obiliqit | 1 |
| 23 | Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale | 1 |
| 24 | Komuna e Ferizajt | 1 |
| 25 | Komuna e Klinës | 1 |
| 26 | Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës | 1 |
| 27 | Prokuroria e Shtetit | 1 |
| 28 | Zyra e Kryeministrit | 1 |
| 29 | Komuna e Deçanit | 1 |
| 30 | Univeristeti i Mitrovicës | 1 |
| 31 | Këshilli i Pavarur Mbikëqyres për Shërbimin Civil | 1 |
| 32 | Komisioni i Pavarur për Media | 1 |
| 33 | Zyra e Presidencës | 1 |
| 34 | Inspektorati i Punës | 1 |
| 35 | Administrata Tatimore e Kosovës | 1 |
| 36 | Agjencia Kosovare për Produkte Medicinale | 1 |
| Gjithsejt | | 104 |

12. REKOMANDIMET DHE SFIDAT E KËSHILLIT

Hapësirat për punë, buxheti dhe stafi mbështetës

Këshilli gjatë vitit 2016 është përballur me vështirësi dhe probleme të shumta, mungesës së mjeteve financiare, mungesës së hapësirave elementare për punë, e po ashtu edhe mungesës së stafit mbështetës, por ka arritur që gjatë vitit 2016, të përmbush funksionet kushtetuese dhe ligjore.

Hapësirat të punës për vitin 2016 - Këshilli është vendosur në një pjesë të vogël të ish ndërtesës së Gërmisë dhe akomodimi i 5-6 zyrtarëve në një hapësirë prej 20 m², ka vështirësuar punën e anëtarëve dhe zyrtarëve të Këshillit, në shqyrtimin dhe zgjidhjen efikase të lëndëve, mbajtjen e seancave dëgjimore dhe seancave të kolegjeve për shqyrtimin e ankesave, si dhe mbajtjen e takimeve të Këshillit.

Gjatë gjashtë mujorit të dytë të vitit 2016, Ministria e Administratës Publike ka aprovuar kërkesën e Këshillit lidhur me renovimin e zyrave dhe ndarjen e hapësirave të reja për stafin mbështetës. Me këtë rast, janë krijuar hapësira më të mira për punën e Këshillit dhe të sekretarisë.

Buxheti për vitin 2016- është një nga sfidat me të cilat është përballur Këshilli në të gjitha vitet paraprake, e veçanërisht në vitin 2016. Kjo mungesë ka kufizuar në masë të madhe ushtrimin e funksioneve të Këshillit, me theks të veçantë, ushtrimin e funksionit të mbikëqyrjes të zbatimit të parimeve dhe rregullave të shërbimit civil nga institucionet qendrore dhe lokale, si dhe nga përfaqësitë diplomatike jashtë vendit. Si pasojë e kësaj kemi pasur kufizim të mundësive në realizimin e Planit Vjetor të Monitorimit të Këshillit për vitin 2016, respektivisht për shkak të pamundësive buxhetore për mbulimin e shpenzimeve të detyrueshme, jemi detyruar që të kufizojmë numrin e monitorimeve në organet e punësimit në të cilat ka nëpunës civilë.

Me Ligjin për buxhet të vitit 2017, Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Kuvendi, e kanë ngritur buxhetin e Këshillit në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve mbi 100%, duke i mundësuar që tash e tutje të ketë një buxhet stabil dhe më të cilin mund të realizohen funksionet kushtetuese dhe ligjore.

Stafi mbështetës – Këshilli i ka dërguar një kërkesë Kuvendit të Kosovës, që gjatë amendamentimit të Ligjit për buxhet për vitin 2017 të merr parasysh, kërkesën e arsyeshme të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës për aprovimin e katër pozitive të cilat paraprakisht janë shqyrtuar dhe miratuar nga Komisioni i përbashkët MAP-MF, miratuar nga ministri i administratës publike dhe ministri i financave si dhe aprovuar nga Qeveria në kuadër të klasifikimit të vendeve të punës në shërbimin civilë.

Pozitat kanë qenë si në vijim:

1. Zyrtar certifikues
2. Zyrtar financiar – zotues
3. Zyrtari i depos (pranim të mallit)
4. Zyrtar shpenzues

Këto pozita janë të obliguara që t'i ketë një organizatë buxhetore, në bazë Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi, të Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2009 mbi Delegimin e Menaxhimit të Shpenzimeve të Organizatave Buxhetore si dhe me Rregullat e Thesarit: 01 dhe 02 të cilat saktësisht përcaktojnë numrin e zyrtarëve financiarë nëpër organizatat e pavarura buxhetore.

Aktualisht këto detyra dhe përgjegjësi të këtyre pozitave, kryhen si punë shtesë nga bashkëpunëtorët profesional të Këshillit të cilët janë jurista me profesion.

Po ashtu, Këshilli ka kërkuar që të aprovohet edhe kërkesa edhe për një pozitë të Zyrtarit të lartë për bashkëpunim profesional në mënyrë që secili anëtarë i Këshillit të ketë nga një bashkëpunëtor profesional.

Kërkesat e Këshillit për pozita shtesë nuk janë aprovuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

13. VLERËSIM I PËRGJITHSHËM I RESPEKTIMIT TË RREGULLAVE DHE PARIMEVE QË RREGULLOJNË SHËRBIMIN CIVIL NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

Këshilli, duke u mbështetur në të dhënat e grumbulluara nga ushtrimi i funksioneve kushtetuese dhe ligjore, gjegjësisht shqyrtimit të ankesave, procesit të vëzhgimit të emërimeve të nëpunësve civil të nivelit drejtues dhe procesit të mbikëqyrjes së zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, në institucionet e administratës publike të nivelit qendror dhe lokal, ka arritur që të nxjerrë një vlerësim të përgjithshëm për zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil për fushat përkatëse si dhe të paraqes rekomandimet për institucionet kompetente me qëllim të evitimit të shkeljeve të evidentuara.

Po ashtu, Këshilli në këtë raport paraqet edhe rekomandimet e përgjithshme për legjislacionin e shërbimit civil, respektivisht të plotësimit dhe ndryshimit të legjislacionit primar dhe sekondar si dhe propozimet për nxjerrjen e akteve të reja nënligjore për të rregulluar fusha të caktuara brenda shërbimit civil të cilat nuk janë rregulluar me dispozita përkatëse dhe të cilat po shkaktojnë probleme në funksionimin e institucioneve të administratës publike.

Vlerësimi i fushave përkatëse bazohet në numrin e ankesave të pranuar dhe shqyrtuara, mënyrën e vendosjes lidhur me këto ankesa, të gjeturat dhe rekomandimet nga procesi i monitorimit të institucioneve si dhe procesin e vëzhgimit të emërimit të nëpunësve civilë në pozitat e nivelit drejtues.

PRANIMI NË SHËRBIMIN CIVIL

Këshilli, gjatë vitit 2016 lidhur me procedurat e rekrutimit ka pranuar 205 ankesa kundër procedurave të rekrutimit në shërbimin civil. Po ashtu, Këshilli ka marr pjesë në 248 procedura të vëzhgimit lidhur me procesin e emërimeve të nëpunësve civil të nivelit drejtues. Nga 248 pozita që janë vëzhguar, Këshilli ka aprovuar si procedura të rregullta 104 Pozita, ndersa janë anuluar 144 pozita të rekrutimit për shkak të shkeljeve ligjore dhe procedurale.

Këshilli ka konstatuar se institucionet e administratës publike, nuk kanë arritur në nivel të knaqëshëm të zbatojnë dispozitat e përcaktuara me aktet ligjore dhe nënligjore, lidhur me procedurën e rekrutimit dhe pranimit të nëpunësve civilë në shërbimin civil (qoftë përmes procedurave të avancimit, apo procedurave të jashtëme të rekrutimit). Në bazë të të dhënave të grumbulluara nga ushtrimi i funksioneve kushtetuese dhe ligjore, Këshilli konstaton se shkeljet me të shpeshta gjatë zhvillimit të procedurës së rekrutimit, janë si në vijim:

- mos respektimi i afateve për zhvillimin e procedurave të rekrutimit;
- lëshimi i autorizimit për shpallje nga DASHC/MAP me kritere të ndryshme për pozitat e njëjta;
- themelimi i Komisionit Përzgjedhës për Shërbimin Civil (KPSHC) në kundërshtim me dispozitat ligjore;
- dështimi i KPSHC në llogaritjen e përvojës së punës së kandidatëve për pranim në shërbimin civil;
- përgatitja e testit me shkrim dhe me gojë në kundërshtim me dispozitat ligjore.

Këshilli konstaton se institucionet e administratës publike kanë pasur vështirësi për marrjen e konfirmimit të buxhetit lidhur me marrjen e autorizimit të shpalljes së konkurseve nga Ministria e Financave e cila në raste të caktuara nuk ju ka kthyer përgjigje me muaj të tërë, duke krijuar vështirësi në plotësimin e pozitave të lira tek institucionet dhe rrjedhimisht duke krijuar vështirësi në funksionimin e tyre.

Sipas rekomandimit të dhënë në Raportin vjetor të punës për vitin 2015, Ministria e Administratës Publike ka filluar procedurën e plotësim - ndryshimit të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

Këshilli ka dhënë kontributin profesional në hartimin e draftit fillestar të Rregullores për plotësim- ndryshimin e Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

Këshilli ka vërejtur se Ministria e Administratës Publike gjatë vitit 2016, ka ndërmarr disa veprime administrative të cilat nuk kanë qenë në pajtim me rregullat dhe procedurat, si në vijim:

Për pozita të nivelit drejtues ka ndodhur që është miratuar konkurs i jashtëm, pa u zhvilluar fare procedura të konkursit të brendshëm ashtu siç përcaktohet me legjislacionin në fuqi.

Në disa raste, Ministria e Administratës Publike, ka lëshuar autorizim për procedurën e rekrutimit, duke përcaktuar si kriter të shkollimit „Shkollimi Universitar sistem i shkollimit 4 vjeçar ose titulli master sipas sistemit të Bolonjës, përderisa në shumicën e autorizimeve të lëshuara nga DASHC/MAP, nuk bëhet kjo ndarje por përcaktohet vetëm „diplomë universitare”, dhe drejtimi përkatës i shkollimit.

Në disa raste DASHC/MAP, ka lëshuar autorizim për procedurën e rekrutimit për një pozitë të caktuar, duke përcaktuar si kriter të shkollimit vetëm „Diplomë universitare” përderisa në shumicën e autorizimeve të lëshuara nga DASHC/MAP, për të njëjtën pozitë në institucion tjetër, është përfshirë kriteri i kualifikimit „diplomë universitare”, dhe drejtimi përkatës i shkollimit.

Këshilli gjatë shqyrtimit të ankesave të kandidatëve për pranim në shërbimin civil dhe vëzhgimit të procedurave për emërimin e nëpunësve civilë të nivelit drejtues, ka vërejtur se në disa raste kandidatët kanë shprehur shqetësimin se pranimi në shërbimin civil është bërë mbi bazën e lidhjeve politike apo në baza nepotike.

Sa i përket, përfshirjes së mekanizmave tjerë në procedurat e rekrutimit në shërbimin civil, Këshilli tërheqë vërejtjen se pranimi në shërbimin civilë duhet të behët vetëm nga mekanizmat e përcaktuar me legjislacionin e shërbimit civilë dhe nuk mund të ketë mekanizma tjerë në vlerësimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve. Ndërsa, në rolin e vëzhgimit të procesit, institucionet e administratës publike, kur të vlerësojnë, në kuadër të transparencës dhe me qëllimin më të mirë që kandidatët të përzgjedhen sipas parimit të meritës, mund të angazhohjnë mekanizma vendor e ndërkombetar. Në këtë frymë, Këshilli e vlerëson edhe Memorandumin e Bashkëpunimit të lidhur ndërmjet Kuvendit të Republikës së Kosovës, Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandes Veriore e përfaqësuar nga Ambasada Britanike në Republikën e Kosovës, i nënshkruar me 15.08.2016, që

ka të bëjë me ndihmën e institucioneve të Republikës së Kosovës në procedurat e rekrutimit për pozitat e nivelit të lartë drejtues.

Kriteri i përvojës së punës për pranim në shërbimin civilë

Këshilli konstaton që kriteret e përvojës profesionale të punës për pozitat e nivelit tekniko-administrativ dhe për pozitat e nivelit profesional të përcaktuara me dispozitat e Rregullores Nr. 05/2012 per Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civilë duhet të rishqyrtohen sepse si rrjedhojë e këtyre kriterëve është e pamundur që të rinjtë që kryejnë studimet të përfshihen në shërbimin civil të Republikës së Kosovës.

Këshilli gjatë kryerjes së funksionit për shqyrtimin e ankesave dhe funksionit të monitorimit ka vërejtur së shumë kandidatë që kanë aplikuar për pozita të lira në shërbimin civilë, kanë pasur vërtetime për përvojën e punës të lëshuar nga kompani të sektorit privat të cilat nuk kanë mundur të dëshmojnë në raste të caktuara nga institucionet kompetente, si Trusti Pensional apo Administrata Tatimore e Kosovës.

REKOMANDIME

Duke marr parasysh konstatimet e mësipërme në këtë fushë, Këshilli jep këto rekomandime, që:

1. *Ministria e Administratës Publike, Qeveria dhe Kuvendi duhet të ndërmarrin të gjitha veprimet që në plotësim-ndryshim të Ligjit për Shërbimin Civil të përcaktojnë bazen ligjore për aplikimin e sistemit të centralizuar të rekrutimit, në formë grupore dhe me aplikimin e listës së pritjes për një afat të caktuar. Rekrutimi i centralizuar duhet të bëhet në një qendër apo nga një mekanizëm i veçantë, dhe nën vëzhgimin e procesit nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyres, institucionet tjera, si Avokati i Popullit, Agjencia Kundër Korrupsionit, mekanizmat ndërkombëtar, shoqëria civile dhe mediat.*
2. *Duhet të shqyrtohet mundësia e aplikimit të sistemit elektronik të testimit të kandidatëve. Këshilli konstaton se aplikimi i sistemit të centralizuar dhe i sistemit elektronik të testimit do të ndikoj dukshëm në pranimin e kandidatëve të suksesshëm në shërbimin civil duke u bazuar në parimin e meritës.*
3. *Tek sistemi i centralizuar i rekrutimit lidhur me nëpunësit civil tek institucionet e pavarura kushtetuese duhet të veprohet në pajtim me dispozitat ligjore, duke marr parasysh ruajtjen e pavarësisë funksionale dhe institucionale të institucioneve të pavaruara kushtetuese.*
4. *Për të gjitha pozitat e nivelit drejtues, Ministria e Administratës Publike të kujdeset që të lëshoj autorizimin për procedurën e jashtme të rekrutimit, vetëm pas përfundimit të procedurës së brendshme të rekrutimit, me përjashtim të rasteve specifike kur me akt të posaqëm është përcaktuar ndryshe (drejtorët e shkollave, drejtorët e Qendrave Kryesore të Mjekësisë Familjare, drejtorët e institucioneve kulturore, etj).*

5. *Për të gjitha procedurat e rekrutimit dhe për të gjitha pozitat, autorizimi nga DASHC/MAP, duhet të përmbaj drejtimin e saktë të shkollimit duke marr parasysh pozitën dhe përshkrimin e detyrave të punës, e jo vetëm kriterin e përgjithshëm „Diplomë universitare”.*
6. *Me rastin e miratimit të procedurës së rekrutimit, DASHC/MAP, të zbatohet kriterin e njëjtë në lidhje me kriterin e kualifikimit lidhur me diplomën universitare, shkollimin 4 vjeçar apo titullin master sipas sistemit të Bolonjës.*
7. *Ministria e Administratës Publike dhe Qeveria e Republikës së Kosovës të ndërmarrin të gjitha veprimet për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 05/2012 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civilë dhe Katalogun e Vendeve të Punës në Shërbimin Civilë, duke i shqyrtuar kriterin e përvojës së punës për pranim në shërbimin civil, në pozitë e nivelit tekniko-administrativ dhe në nivelin profesional.*

PËRFAQËSIMI ETNIK NË SHËRBIMIN CIVILË

Kushtetuta e Republikës së Kosovës e ka përcaktuar se: *“Përbërja e shërbimit civil do të pasqyrojë shumëllojshmërinë e popullit të Kosovës, duke marrë në konsideratë parimet e barazisë gjinore, të njohura ndërkombëtarisht”.*

Këshilli konstaton se me nenin 11 të Ligjit për Shërbimin Civil, është përcaktuar përfaqësimi i komuniteteve jo shumicë, në të dy nivelet e organizimit të administratës publike, në nivelin qendror dhe në nivelin lokal.


Dispozitat ligjore kanë përcaktuar se në kuadër të shërbimit civil në institucionet e nivelit qendror minimum 10% e posteve duhet të rezervohen për personat të cilët u përkasin komuniteteve të cilët nuk janë shumicë në Kosovë dhe që përmbushin kriteret specifike të punësimit. Në nivelin komunal për anëtarët e kualifikuar të komuniteteve që nuk janë shumicë në komunë, do të jetë i rezervuar numri i vendeve të punës në pajtim me përfaqësimin procentual të komuniteteve të komunës përkatëse.

Ministria e Administratës Publike ka nxjerr Rregulloren nr. 04/2010 për procedurat e përfaqësimit të drejtë dhe proporcional të komuniteteve jo shumicë në shërbimin civil të Kosovës, e cila i përcakton kushtet dhe procedurat e përfshirjes së komuniteteve jo shumicë në shërbimin civilë.

Këshilli, duke u bazuar në statistikat e dhëna nga Ministria e Administratës Publike, të cilat janë të përpunuara deri me datën 30 shtator 2016, konstaton se nga 18542 të punësuar në shërbimin civilë, 11716 nëpunës civilë janë të punësuar në nivel qendror, ndërsa 6826 nëpunës civilë janë të punësuar në nivel komunal.

Numri i nëpunësve civilë të punësuar në administratën qendrore dhe lokale


| | | |
|--------------|--------------------|-----------|
| Administrata | Nr.i të punësuarve | Përqindja |
| Qendrore | 11716 | 63.18% |
| Lokale | 6826 | 36.81% |
| Totali | 18542 | 100% |



Këshilli konstaton se nga 18542 nëpunës civilë të punësuar në shërbimin civilë të Kosovës, prej tyre 16400 nëpunës civilë ose 88.44% janë të përkatësisë etnike shqiptare si shumicë, ndërsa komunitet jo shumicë janë të përfaqësuar me 11.56% si në vijim: 1565 nëpunës civilë ose 8.44% janë të përkatësisë etnike serbe, 243 nëpunës civilë ose 1.31% të përkatësisë etnike boshnjake, 215 nëpunës civilë ose 1.15% të përkatësisë etnike turke, 35 nëpunës civilë ose 0.18% të përkatësisë etnike rome, 32 nëpunës civilë ose 0.17% të përkatësisë etnike ashkali, 23 nëpunës civilë ose 0.12% të përkatësisë etnike goran, 18 nëpunës civilë ose 0.09% të përkatësisë etnike egjiptiane dhe 11 nëpunës civilë ose 0.06% të përkatësive tjera etnike (kroat, malazez).

Gjithsejt në administratën qendrore dhe komunale sipas strukture etnike


| Shqiptar | Serb | Boshnjak | Turq | Goran | ashkali | egjiptian | rom | Të tjerë | gjithsejt |
|----------|-------|----------|-------|-------|---------|-----------|-------|----------|-----------|
| 16400 | 1565 | 243 | 215 | 23 | 32 | 18 | 35 | 11 | 18542 |
| 88.44% | 8.44% | 1.31% | 1.15% | 0.12% | 0.17% | 0.09% | 0.18% | 0.06% | 100% |



Këshilli, duke u mbështetur në statistika, konstaton se në nivel qendror, nga 11716 të punësuar, 10716 ose 91.45% janë nëpunës civilë shqiptar, ndërsa komunitet jo shumicë janë 1000 ose 8.55%, si në vijim: 705 janë nëpunës civilë serb, 117 nëpunës civilë boshnjak, 124 nëpunës civilë turq, 16 nëpunës civilë goran, 8 nëpunës civilë ashkali, 5 nëpunës civilë egjiptian, 18 nëpunës civilë rom dhe 7 nëpunës civilë të tjerë (kroat, malazez).

Struktura etnike në administratën qendrore

| Shqiptar | Serb | Boshnjak | Turq | Goran | Ashkali | Egjiptian | Rom | Të tjerë | Gjithsëjt |
|----------|-------|----------|-------|-------|---------|-----------|-------|----------|-----------|
| 10716 | 705 | 117 | 124 | 16 | 8 | 5 | 18 | 7 | 11716 |
| 91.45% | 6.01% | 0.99% | 1.05% | 0.13% | 0.08% | 0.04% | 0.15% | 0.06% | 100% |



Nëse marrim parasysh edhe pranimet e reja në fund të vitit 2016 në shërbimin civil të komunitetit serb lidhur me inkuadrimin e strukturave paralele në sistemin e drejtësisë të Republikës së Kosovës, sipas Marrëveshjes së Brukselit, mund të konstatohet se shifrat e përcaktuara me ligj për përfaqësimin e 10% të komuniteteve jo shumicë në shërbimin civil në nivel qendror, pothuajse janë përmbushur. Këshilli konstaton se komuniteti serb, dhe deri diku edhe komuniteti turk dhe boshnjak janë të përfaqësuara mirë në shërbimin civil në nivel qendror, por, komunitetet tjera jo shumicë, si komuniteti ashkali, rom, egjiptian dhe goran janë të nënpërfaqësuara në shërbimin civil në nivel qendror.

Këshilli, ka kërkuar nga Ministria e Administratës Publike që të shfrytëzoj mekanizimin e dhënies së aprovimit për shpalljen e konkurseve, duke obliguar institucionet që nuk kanë arritur nivelin e përfaqësimit, që të shpallin paraprakisht konkurs vetëm për komunitete jo shumicë që janë të nënpërfaqësuara, derisa të përmbushen kuotat e përcaktuara me ligj.

Këshilli i ka rekomanduar Ministrisë së Administratës Publike, që në Rregulloren e re për Procedurat e Rekrutimit e cila është në finalizim, të përfshihet një nen i veçantë që i jep të drejtë eksplicite, Ministrisë së Administratës Publike, që të obligoj institucionet e administratës publike që nuk i kanë përmbushur kuotat e përfaqësimit të komuniteteve jo shumicë, të hapin fillimisht konkurse vetëm për këto komunitete.


Këshilli ka kërkuar që me legjislacionin e ri të shërbimit civil të aplikohet sistemi i centralizuar dhe grupor i rekrutimit, andaj aplikimi i këtij sistemi, mund të jetë zgjidhje e mirë që konkursi

grupor të përcaktoj kuota të caktuara për praninë të komuniteteve të nënperfaqësuar në shërbimin civil derisa të arrihen kuotat e përcaktuara ligjore.

Në nivel komunal, prej gjithsejt 6826 të punësuar në shërbimin civil, 5684 ose 83.27% janë nëpunës civil shqiptar, ndërsa përfaqësimi i komuniteteve jo shumicë 1142 ose 16.73% është si në vijim: 860 nëpunës civil serb, 126 nëpunës civil boshnjak, 91 nëpunës civil turq, 7 nëpunës civil goran, 24 nëpunës civil ashkali, 13 nëpunës civil egjiptian, 17 nëpunës civil rom dhe 4 të tjerë.

Struktura etnike në administratën komunale

| Shqiptar | Serb | Boshnjak | Turq | Goran | ashkali | egjiptian | rom | Të tjerë | gjithsejt |
|----------|-------|----------|-------|-------|---------|-----------|-------|----------|-----------|
| 5684 | 860 | 126 | 91 | 7 | 24 | 13 | 17 | 4 | 6826 |
| 83.27% | 12.6% | 1.84% | 1.33% | 0.10% | 0.35% | 0.19% | 0.29% | 0.58% | 100% |



Gjatë vitit 2016, Kryetari i Këshillit, ka raportuar në Komisionin për Komunitete të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Në këtë takim, deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës të komuniteteve jo shumicë, kanë ngritur shqetësimin se në disa raste institucionet e administratës publike, në emër të komuniteteve kanë punësuar nëpunës civilë të komunitetit etnik të shumicës, prandaj, Këshilli, Ministria e Administratës Publike, deputetët por edhe mekanizmat tjerë vendor e ndërkombëtar, të shoqërisë civile, mediave etj, në kuadër të mandatit dhe angazhimit të tyre, të bejnë hulumtime në menyrë që të verifikohen të dhënat e përfaqësimit etnik, në rastet kur ka dyshime që ndonjë nëpunës civilë është pranuar në shërbimin civil në emër të komuniteteve jo shumicë duke qenë i përkatësisë etnike shqiptare.

Këshilli, në kuadër të mbikëqyrjes së rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, ka nxjerr vendim me të cilin ka vendosur që të nxjerr një Raport të veçantë gjatë vitit 2017 për përfaqësimin etnik të komuniteteve jo shumicë në shërbimin civil, pasi që të përpunohen të gjitha të dhënat e përfaqësimit etnik të vitit 2016 nga Ministria e Administratës Publike. Me këtë rast, në detaje do të nxjerrën statistikat e përfaqësimit etnik, për secilin institucion, me theks të veçantë për komunat.

Po ashtu, Këshilli në Pytësorin e monitorimit të institucioneve, tashmë ka përfshirë një fushë të veçantë, mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit të shërbimit civil nga institucionet e administratës publike sa i përket përfaqësimit etnik, në nivel qendror dhe lokal. Në Raportet e Monitorimit do të konstatohet gjendja dhe do të japen rekomandime konkrete edhe për secilin institucion i cili nuk ka përmbushur obligimin ligjor për përfaqësimin etnik.

REKOMANDIME

Duke marr parasysh konstatimet e mësipërme në këtë fushë, Këshilli jep këto rekomandime, që:


1. *Qeveria e Republikës së Kosovës, respektivisht Ministria e Administratës Publike të përcaktoj mekanizmin më të cilin obligon institucionet e administratës publike, në nivel qendror dhe komunal që të plotësojnë kriterin e përfaqësimit etnik, duke bërë një plan të veçantë për komunitetet jo shumicë ashkali, rom, goran dhe egjiptas sepse janë të nënpërfaqësuar në shërbimin civilë.*
2. *Të gjithë zyrtarët kryesor administrativ, sidomos ata në nivel komunal, të ndërmarrin veprime që gjatë procedurave të rekrutimit, të kenë parasysh, që të plotësojnë kuotat e përfaqësimit etnik sipas dispozitave ligjore në fuqi.*
3. *Të gjithë zyrtarët kryesor administrativ dhe udhëheqësit e burimeve njerëzore në institucionet e administratës publike që të rishikojnë listat e nëpunësve civilë dhe të paraqesin drejtë të dhënat lidhur me përkatësinë etnike të nëpunësve civilë në kuadër të institucionit të tyre.*

PËRFAQËSIMI GJINORË NË SHËRBIMIN CIVILË

Këshilli duke u bazuar në të dhënat e siguruara nga Ministria e Administratës Publike konstaton se në shërbimin civil të Kosovës janë të punësuar 18542 nëpunës civilë, prej tyre 11635 ose 62.75% janë nëpunës civilë të gjinisë mashkullore, ndërsa 6907 ose 37.25% nëpunës civilë të gjinisë femërore.

Përfaqësimi sipas strukture gjinore


| | | |
|-----------|-------|--------|
| Mashkuj | 11635 | 62.75% |
| Femra | 6907 | 37.25% |
| Gjithsejt | 18542 | 100% |



Këshilli konstaton se përqindja e punësimit të femrave në shërbimin civil nuk është përmbushur nëse marrim parasysh dispozitat e Ligjit për barazinë gjinore i cili në nenin 6 paragrafi 8 ka përcaktuar se “Përfaqësimi i barabartë gjinor në të gjitha organet legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore dhe institucionet e tjera publike arrihet kur sigurohet përfaqësim minimal prej pesëdhjetë përqind (50%) për secilën gjini, përfshirë edhe organet e tyre drejtuese dhe vendimmarrëse”. Kjo dispozitë nuk është përcaktuar në Ligjin për shërbimin civil, por është përcaktuar në përgjithësi parimi i mosdiskriminimit në baza gjinore dhe mundësive të barabarta për pjesëmarrje në shërbimin civil për femrat dhe meshkujt.

Struktura gjinore në administratën qendrore


| | | |
|-----------|-------|--------|
| Mashkuj | 6842 | 58.40% |
| Femra | 4874 | 41.60% |
| Gjithsejt | 11716 | 100% |



Këshilli konstaton se nga 11716 nëpunësve civilë të punësuar në nivel qendror të administratës publike, 6842 ose 58.40% janë nëpunës civilë të gjinisë mashkullore, ndërsa 4874 ose 41.60% janë nëpunës civilë të gjinisë femërore.

Struktura gjinore në administratën lokale

| | | |
|-----------|------|--------|
| Mashkuj | 4793 | 70.21% |
| Femra | 2033 | 29.79% |
| Gjithsejt | 6826 | 100% |



Këshilli konstaton se në nivel komunal janë të punësuar 4793 ose 70.21% nëpunës civilë të gjinisë mashkullore, ndërsa 2033 ose 29.79% janë të punësuar nëpunës civilë të gjinisë femërore.

Përfaqësimi i gjinisë femërore në pozita të nivelit të lartë drejtues është minimal sepse nga 76 pozita të nivelit të lartë drejtues, 72 ose 94.7% janë të gjinisë mashkullore, ndërsa vetëm 4 pozita ose 5.3% janë të gjinisë femërore. Ndërsa, në pozita të nivelit drejtues në institucionet e administratës publike në nivel qendror, nga 1338 pozita të nivelit drejtues, 971 ose 72.57% janë nëpunës civil të nivelit drejtues të gjinisë mashkullore, ndërsa 367 ose 27.43% janë pozita të nivelit drejtues të gjinisë femërore. Në institucionet e administratës publike në nivel lokal, nga 874 pozita të nivelit drejtues, 702 pozita ose 80.3% janë nëpunës civilë të nivelit drejtues të gjinisë mashkullore, ndërsa 172 pozita ose 19.7% janë nëpunës civilë të nivelit drejtues të gjinisë femërore.

Këshilli, në kuadër të mbikëqyrjes së rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, ka nxjerr vendim me të cilin ka vendosur që të nxjerr një Raport të veçantë gjatë vitit 2017 për përfaqësimin gjinor në shërbimin civil, pasi që të përpunohen të gjitha të dhënat e përfaqësimit gjinor të vitit 2016 nga Ministria e Administratës Publike. Me këtë rast, në detaje do të nxjerrën statistikën e përfaqësimit gjinorë, me theks të veçantë për përfaqësimin gjinor në pozita të nivelit drejtues dhe në pozita të nivelit të lartë drejtues. Sipas të dhënave të përgjithshme, përfaqësimi i gjinisë femërore në pozitat e nivelit drejtues dhe në pozita të nivelit të lartë drejtues shërbimin civil nuk është i kënaqshëm.

Po ashtu, Këshilli në Pytëtorin e monitorimit të institucioneve, tashmë ka përfshirë një fushë të veçantë, mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit të shërbimit civil nga institucionet e administratës publike sa i përket përfaqësimit gjinor, në nivel qendror dhe lokal. Në Raportet e Monitorimit do të konstatohet gjendja dhe do të japen rekomandime konkrete edhe për secilin institucion lidhur me përfaqësimin gjinorë.

REKOMANDIME

Duke marr parasysh konstatimet e mësipërme në ketë fushë, Këshilli jep këto rekomandime, që:

1. *Institucionet e administratës publike të nivelit qendror dhe lokal të angazhohen në pranimin e më shumë nëpunësve civilë të gjinisë femërore në kuadër të shërbimit civil në nivel qendror dhe lokal.*
2. *Ministria e Administratës Publike dhe Qeveria e Republikës së Kosovës të angazhohen me shumë në përfaqësimin e gjinisë femërore në pozita të nivelit drejtues në shërbimin civil në nivel qendror dhe lokal.*
3. *Ministria e Administratës Publike dhe Qeveria e Republikës së Kosovës të ndërmarrin veprime urgjente lidhur me përfaqësimin e gjinisë femërore në pozita të nivelit të lartë drejtues sepse përfaqësimi i gjinisë femërore në këtë nivel të përfaqësimit në shërbimin civilë është minimal dhe si rrjedhojë nuk është në pajtim me parimin e barazisë gjinore.*

PROCEDURAT DISIPLINORE DHE PROCEDURAT E ANKESAVE

Këshilli, duke u mbështetur në ankesat e shqyrtuara gjatë vitit 2016, ka konstatuar se Komisionet Disiplinore në shumë raste nuk kanë arritur që të zhvillojnë procedurat duke u mbështetur në dispozitat ligjore dhe afatet e përcaktuara, respektivisht nuk kanë arritur që të përcaktojnë saktë masën disiplinore, në proporcion me shkeljet e evidentuara, si dhe në disa raste kanë vendosur jashtë afatit të përcaktuar ligjor, duke bërë që këto vendime të shpallen akte absolutisht të pavlefshme dhe të mos krijojnë asnjë pasojë juridike. Ky fakt, tregon që Komisionet Disiplinore, duhet të jenë më të përgjegjshme për të ushtruar mandatin e tyre, duke u mbështetur në procedura sepse tejkalimi i afatit ligjor për vendosje nga ana e Komisionit, shkakton dëme të pariparueshme për institucionin, duke pas parasysh se shkelësi i supozuar, edhe pse po vërtetohet se ka bërë shkelje, po kthehet në vendin e tij të punës për shkak se Komisioni po e zhvillon procedurën në kundërshtim me dispozitat e përcaktuara ligjore.

Këshilli, duke u mbështetur në ankesat e shqyrtuara gjatë vitit 2016, ka konstatuar se Komisionet për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në shumë raste nuk kanë arritur që të vërtetojnë drejtë gjendjen faktike dhe ligjore të vendimeve të Komisioneve Disiplinore dhe të vendimeve kundër të cilave është parashtruar ankese, rrjedhimisht, nuk kanë arritur që të zhvillojnë procedurat duke u mbështetur në dispozitat ligjore dhe afatet e përcaktuara. Në disa raste, Komisionet për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave kanë vendosur jashtë afatit të përcaktuar ligjor, duke bërë që këto vendime të shpallen akte absolutisht të pavlefshme dhe të mos krijojnë asnjë pasojë juridike.

Këshilli ka vërejtur se shumica e anëtarëve të Komisioneve Disiplinore dhe të Komisioneve për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave nuk i kanë ndjekur trajnimet e detyrueshme, për çështjet që ndërlidhen me procedurat disiplinore dhe procedurat për zgjidhjen e kontesteve dhe të ankesave, dhe që është urgjente organizimi i trajnimeve për kryesuesit dhe anëtarët e Komisioneve Disiplinore dhe të Komisioneve për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave në

institucionet e administrates qendrore dhe lokale.

Në bazë të të dhënave të grumbulluara nga ushtrimi i funksioneve kushtetuese dhe ligjore, Këshilli konstaton se shkeljet me të shpeshta gjatë zhvillimit të procedurës disiplinore nga Komisioni Disiplinor dhe procedurës së ankimit nga Komisionet për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave, janë si në vijim:

- themelimi i komisionit disiplinor dhe komisionit për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave në kundërshtim me nenin 70 respektivisht nenin 82 të Ligjit për Shërbimin Civil;
- inicimi i procedurës disiplinore nga autoriteti jokompetent;
- mos respektimi i afateve ligjore lidhur me iniciimin dhe zhvillimin e procedurës disiplinore;
- shqiptimi i masave disiplinore në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore;
- mos respektimi i afateve ligjore lidhur me zhvillimin e procedurës disiplinore dhe të procedurës ankimore;
- përgaditja e vendimeve në kundërshtim me formën dhe përmbajtjen e përcaktuar me dispozitat ligjore të Ligjit për Procedurën Administrative.

REKOMANDIME

Duke marr parasysh konstatimet e mësipërme në këtë fushë, Këshilli jep këto rekomandime, që:

1. Ministria e Administrates Publike, Qeveria dhe Kuvendi duhet të ndërmarrin të gjitha veprimet që në plotësim-ndryshim të Ligjit për Shërbimin Civil të përcaktoj bazën ligjore për centralizimin e Komisionit disiplinor dhe Komisionit për zgjidhjen e kontesteve dhe të ankesave, si mekanizma të përhershme në pesë institucione, si në vijim:

1.1. Komisioni disiplinor dhe Komisioni i Ankesave në kuadër të Ministrisë përkatëse për Administratë Publike, me mandat për të shqyrtuar dhe vendosur lidhur me rastet disiplinore, respektivisht zgjidhjen e ankesave për nëpunësit civil në kuadër të degës së ekzekutivit, respektivisht të ministrive dhe organeve në varësi të tyre;

1.2. Komisioni disiplinor dhe Komisioni i Ankesave në kuadër të Ministrisë përkatëse të Administrimit të Pushtetit Lokal, me mandat për të shqyrtuar dhe vendosur lidhur me rastet disiplinore, respektivisht zgjidhjen e ankesave për nëpunësit civil në kuadër të komunave të Kosovës;

1.3. Komisioni disiplinor dhe Komisioni i Ankesave në kuadër të Kuvendit të Republikës së Kosovës, me mandat për të shqyrtuar dhe vendosur lidhur me rastet disiplinore, respektivisht zgjidhjen e ankesave për nëpunësit civil në kuadër të institucioneve të pavarura dhe agjencive që i përgjigjen Kuvendit;

1.4. Komisioni disiplinor dhe Komisioni i Ankesave në kuadër të Këshillit Prokurorial të Kosovës, me mandat për të shqyrtuar dhe vendosur lidhur me rastet disiplinore, respektivisht zgjidhjen e ankesave për nëpunësit civil në kuadër të institucioneve të sistemit prokurorial; dhe

1.5. Komisioni disiplinor dhe Komisioni i Ankesave në kuadër të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me mandat për të shqyrtuar dhe vendosur lidhur me rastet disiplinore, respektivisht zgjidhjen e ankesave për nëpunësit civil në kuadër të institucioneve të sistemit gjyqësor.

2. Me plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Shërbimin Civil duhet të thjeshtësohen procedurat dhe duhet të shkurtohen afatet për ankimim dhe vendimmarrje lidhur me rastet disiplinore dhe të ankesave.

3. Deri në plotësimin dhe ndryshimin e legjislacionit sipas rekomandimeve të mësipërme, i rekomandohet të gjitha institucioneve përgjegjëse që të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme, që të gjithë anëtarët e Komisioneve Disiplinore dhe të Komisioneve për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave, në institucionet e administratës qendrore dhe lokale, të ndjekin trajnimet e detyrueshme, për çështjet që ndërlidhen me procedurat disiplinore dhe procedurat për zgjidhjen e kontesteve dhe të ankesave.

Këshilli konstaton se aplikimi i centralizuar i komisioneve disiplinore dhe komisioneve për zgjidhjen e kontesteve dhe të ankesave do të ndikoj pozitivisht që rastet disiplinore dhe ankesat e nëpunësve civilë të trajtohen nga komisione profesionale dhe të paanshme. Kjo do të ndikoj dukshëm që procedura disiplinore dhe e ankesave të zhvillohet në pajtim me procedurën dhe ligjin dhe përgjegjësia për shkeleje eventuale të procedurave do të adresohet lehtë sepse nëpunësit civilë të këtyre mekanizmave, do të kenë pozita të përhershme.

KLASIFIKIMI I VENDEVE TË PUNËS NË SHËRBIMIN CIVIL

Përkundër angazhimit të institucioneve të administratës publike dhe Ministrisë për Administratë Publike, Këshilli konstaton që Qeveria e Republikës së Kosovës me vendimin nr. 04/89 të datës 25.05.2016 e ka aprovuar klasifikimin e vendeve të punës në shërbimin civilë, por ende nuk është zbatuar procesi i ri i klasifikimit dhe sistematizimit të vendeve të punës.

Këshilli, ka konstatuar se vonesa për të finalizuar procesin e klasifikimit dhe sistematizimit të vendeve të punës në shërbimin civil, ka bërë që ende të mos kemi një sistem të standardizuar të pagave si dhe procesi i ri i vlerësimit të mos aplikohet sepse është i lidhur ngushtë më procesin e sistematizimit dhe klasifikimit të vendeve të punës. Kjo gjendje ka bërë që mos të zbatohet plotësisht sistemi i avancimit të nëpunësve civilë, duke cenuar procesin e zhvillimit të karrierës së nëpunësve civilë.

Procesi i klasifikimit dhe sistematizimit të vendeve të punës në shërbimin civil, është i domosdoshëm dhe do të mundësoj që të kemi një sistem të standardizuar të pagave si dhe zbatimin e plotë të procesit të vlerësimit të nëpunësve civilë.

REKOMANDIME

Duke marr parasysh konstatimet e mësipërme në ketë fushë, Këshilli jep këto rekomandime, që:

1. *Qeveria e Republikës së Kosovës urgjentisht të ndërmarr të gjitha veprimet për zbatimin e sistemit të klasifikimit dhe sistematizimit të vendeve të punës në shërbimin civil.*
2. *Qeveria dhe Kuvendi i Kosovës të analizojnë dhe të marrin parasysh të gjitha rrethanat lidhur me sistemin e klasifikimit dhe sistematizimit të vendeve të punës në shërbimin civil, në mënyrë që me Ligjin e ri për pagat të mos dëmtohet procesi për të cilin është punuar nga viti 2010.*

VLERËSIMI I KRYERJES SË PUNËVE

Këshilli, duke u mbështetur në Raportet e Monitorimit të zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit të shërbimit civil në institucionet e administratës publike, ka konstatuar se në 32 institucione të administratës publike, janë gjetur shkelje lidhur me vlerësimin e nëpunësve civilë sepse disa epurorë nuk kanë kryer vlerësimin e kryerjes së punëve të nëpunësve të tyre për vitin kalendarik në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Këshilli, ka konstatuar se në vitin 2016, edhe pse ka filluar të aplikohet sistemi i ri i vlerësimit duke u mbështetur në dispozitat e Rregullores Nr. 19/2012 për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civilë, ky vlerësim është përcjellë me parregullsi dhe paqartësi të shumta, duke pas parasysh se është i komplikuar dhe është i ndërlidhur drejtpërdrejtë me sistemin e klasifikimit dhe sistematizimit të vendeve të punës në shërbimin civil, i cili nuk është miratuar ende nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Këshilli konstaton se vlerësimi i punës së nëpunësve civilë nuk kryhet në pajtim me objektivat dhe aktivitetet e nëpunësve civilë sepse në shumë raste mungojnë planet vjetore të nëpunësve civilë mbi bazen e të cilave do të duhej të kryhej vlerësimi i punës së nëpunësve civilë.

Këshilli konstaton se në shumë raste, vlerësimi i punës së nëpunësve civilë bëhet jashtë afateve të përcaktuara ligjore, dhe në disa raste, është vërejtur se tek pozitat e nivelit drejtues dhe tek pozitat e nivelit të lartë drejtues, vlerësimi i punës së tyre nuk bëhet me vite të tëra.

REKOMANDIM

Rekomandohet Ministria e Administratës Publike, Qeveria dhe Kuvendi që të analizojnë sistemin e vlerësimit të nëpunësve civilë duke i rishikuar kufizimet e përcaktuara për nivelet e vlerësimit, respektivisht limitet e përcaktuara për tri kategoritë funksionale, sepse të njëjtat nuk kanë gjetur zbatim në institucionet e administratës publike. Rrjedhimisht, institucionet kompetente, duhet të plotësojnë dhe ndryshojnë Ligjin Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë dhe Rregulloren Nr. 19/2012 për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civilë, në mënyrë që të jetë i aplikueshëm sistemi që krijon ndërlidhjen në mes të procesit të vlerësimit dhe ecjes në hapa në procesin e gradimit dhe pages.

TRANSFERIMI I NËPUNËSVE CIVILË

Këshilli duke u mbështetur në Raportet e Monitorimit të zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit të shërbimit civil, në institucionet e administratës publike, si dhe duke u mbështetur në ankesat e shqyrtuara, gjatë vitit 2016, ka konstatuar se në disa institucione të administratës publike, transferimet janë bërë në kundërshtim me nenin 16 dhe 28 të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, dhe Rregullores Nr. 06/2010 për Transferimin e Nëpunësve Civilë.

Tek transferimet e përhershme të nëpunësve civilë, shkeljet kryesisht kanë qenë se këto transferime janë bërë pa pëlqimin e nëpunësit civil, që është një nga kushtet që duhet plotësuar për t'u konsideruar transferimi i përhershëm si transferim i ligjshëm.

Tek transferimet e përkohshme të nëpunësve civil, shkeljet kryesisht kanë qenë sepse këtu transferet janë bërë pa e përcaktuar saktë kohëzgjatjen e transferit të përkohshëm, ndërsa tek pozitat e nivelit drejtues transferimet janë bërë në kohëzgjatje me shumë se 6 muaj, e që është në kundërshtim me nenin 16 të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

REKOMANDIM

Rekomandohet Ministria e Administratës Publike dhe Qeveria e Kosovës, që të plotësojnë dhe ndryshojnë Rregulloren Nr. 06/2010 për Transferimin e Nëpunësve Civilë, duke përcaktuar kriteret dhe procedurat e transferimit të përhershëm dhe të përkohshëm në pajtim me dispozitat e Ligjit për Shërbimin Civil.

PUSHIMET NË SHËRBIMIN CIVIL

Këshilli, duke u mbështetur në Raportet e Monitorimit të zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit të shërbimit civil, në institucionet e administratës publike ka konstatuar që procedurat e pushimeve të nëpunësve civilë kryesisht kryhen sipas dispozitave të përcaktuara me Rregulloren Nr. 06/2011 për Pushimet e Nëpunësve Civilë.

Këshilli gjatë procedurave të monitorimit të institucioneve, ka vërejtur që institucionet në disa raste kanë aplikuar pushime për nëpunësit civil, të cilat nuk janë të përcaktuara me rregulloren përkatëse (si psh. pushimi me rastin e zhvendosjes nga banesa).

Këshilli gjatë procedurave të monitorimit të institucioneve, ka vërejtur që institucionet në disa raste nëpunësve civilë u kanë aprovuar pushimet me pagesë dhe pa pagesë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

REKOMANDIME

Duke marr parasysh konstatimet e mësipërme në ketë fushë, Këshilli jep këto rekomandime, që

1. *Zyrtarët përgjegjës të institucioneve të administratës publike, që të jenë me të kujdesshëm lidhur me lejimin e pushimeve me dhe pa pagesë duke u thirrur për ngritjen e kapaciteteve, që janë në interes të institucionit, apo që janë në interes të vendit. Kjo normë aplikohet vetëm në rastet kur një specializim i nëpunësit civil, është në interes, për institucionin, ose për interesin e vendit, por nuk aplikohet për studimet e rregullta të nëpunësve civilë.*
2. *Qeveria e Kosovës të ndermarr veprime për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Komepnsimet Tjera të Nëpunësve Civilë, duke përcaktuar qartë kriteret dhe kohën për lejimin e pushimit me dhe pa pagesë tek specializimi i nëpunësve civilë.*
3. *Zyrtarët përgjegjës të institucioneve të administratës publike, , të mos u njohin të drejtën për pushime punonjësve të angazhuar me kontrata për shërbime të veçanta sepse është në kundërshtim me rregullat që përcaktojnë të drejtat e punonjësve që ofrojnë këto shërbime.*

DOSJET E PERSONELIT

Këshilli duke u mbështetur në procesin e monitorimit të zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit të shërbimit civil, në institucionet e administratës publike, ka konstatuar se administrimi dhe mirëmbajtja e dosjeve të personelit, janë në përmirësim të standardeve të përcaktuara me ligj. Në vetëm një numër të vogël të institucioneve të administratës publike është vërejtur se dosjet e personelit nuk mbahen në vende të sigurta. Këshilli, ka konstatuar se dosjet e personelit nuk përditësohen në bazë të rregullave për t'ua bashkangjitur ngritjen dhe zhvillimin profesional individual të nëpunësve civilë.

REKOMANDIM

Rekomandojmë zyrtarët kryesor administrativ të institucioneve të administratës publike që të krijojnë hapësirë të përshtatshme dhe të sigurt si dhe që të mirëmbajnë dhe përditësojnë dosjet e nëpunësve civil në pajtim me dispozitat e Rregullores Nr. 03/2011 mbi Dosjet dhe Regjistrin Qendror të Nëpunësve Civil të Republikës së Kosovës.

MARRËVESHJET PËR SHËRBIME TË VEÇANTA

Këshilli konstaton se institucionet e administratës publike në nivel qendror dhe lokal kanë lidhur një numër të madh të kontratave të quajtura Marrëveshje për Shërbime të Veçanta. Këshilli ka konstatuar se një numër i madh i këtyre kontratave janë lidhur pa aplikuar fare procedurat e thjeshtëzuara të rekrutimit, ashtu siç përcaktohet me nenin 12 paragrafin 4 të Ligjit për Shërbimin Civil. Po ashtu, Këshilli ka konstatuar se në shumë raste janë shkelur afatet e lidhjes se këtyre Marrëveshjeve, duke mundësuar që personat e kontraktuar të punojnë në kohëzgjatje për me shumë se periudha 6 mujore. Këshilli ka evidentuar se në shumë raste personat e angazhuar me Marrëveshje për Shërbime të Veçanta kanë lidhur marrëdhënie pune jo për punë specifike, por në pozitat që kanë qenë të përcaktuara me organogramin e institucionit si pozita të nëpunësve civilë.

Këshilli konstaton se edhe përkundër rekomandimit të dhënë në Raportin e vitit 2015, institucionet e administratës publike kanë vazhduar të lidhin marrëveshje për shërbime të veçanta pa procedurë dhe kritere, si dhe Ministria e Administratës Publike nuk ka ndermarrë veprimet për hartimin e rregullores për procedurat e thjeshtëzuara të rekrutimit.

Këshilli konstaton që personat e angazhuar me Marrëveshje për Shërbime të Veçanta, nuk kanë të drejtë të marrin Akt Emërimi nga institucioni përkatës dhe të futen në listën e pagave me statusin e nëpunësit civilë sepse është në kundërshtim me legjislacionin e shërbimit civil sepse nuk mund të ketë emërimi në shërbimin civil pa ju nënshtruar procedurave të rekrutimit sipas konkursit publik.

REKOMANDIME

Duke marr parasysh konstatimet e mësipërme në këtë fushë, Këshilli jep këto rekomandime, që:

1. *Institucionet e administratës publike duhet që Marrëveshjet për Shërbime të Veçanta t'i lidhin duke u bazuar në një procedurë të thjeshtëzuar të rekrutimit duke i dhënë mundësi të gjithë qytetarëve të interesuar që të aplikojnë për punësim dhe t'i respektojnë afatet e lidhjes së këtyre kontratave deri në 6 muaj.*
2. *Institucionet e administratës publike, mënjëherë duhet të ndalin praktikën e deritanishme për angazhimin e personave me Marrëveshje për Shërbime të Veçanta në pozita të përcaktuara për nëpunës civilë si dhe angazhimi duhet të jetë vetëm për punë specifike.*
3. *Qeveria e Republikës së Kosovës të nxjerr një akt nënligjor i cili do të përcaktoj rregullat dhe procedurat e rekrutimit të thjeshtëzuar për Marrëveshjet për Shërbime të Veçanta;*
4. *Personave që janë të angazhuar me Marrëveshje për Shërbime të Veçanta të mos ju lëshojnë akt emërimi si dhe Ministrisë së Administratës Publike dhe Ministrisë së Financave që të mos i përfshijë në listën e pagave të nëpunësve civilë;*

5. *Kuvendi, Qeveria dhe Ministria e Administratës Publike, në plotësim-ndryshimin e Ligjit për Shërbimin Civilë të fshij nenin për Marrëveshjet për Shërbime të Veçanta sepse personat e angazhuar me këto Marrëveshje nuk e kanë statusin e nëpunësit civilë pasi që këto marrëveshje i nënshtrohen dispozitave ligjore të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve.*

PAGAT, SHITESAT DHE KOMPENSIMET E NËPUNËSVE CIVILË

Këshilli gjatë kryerjes së funksioneve kushtetuese dhe ligjore ka konstatuar në disa raste se nëpunësit civilë marrin paga të ndryshme për punë ose pozitë të njëjtë në institucionet e administratës publike.

Këshilli, vlerëson punën e Ministrisë së Administratës Publike dhe të Qeverisë së Republikës së Kosovës, për miratimin e Ligjit për Pagat dhe dërgimin e tij në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Këshilli konstaton se me ligjin e ri për pagat do të krijohet një rregull për të gjitha kategoritë e administratës publike, duke përfshirë edhe nëpunësit civil, lidhur me sistemin e pagave sipas parimit pagë e njëjtë për punë të njëjtë. Këshilli vlerëson se miratimi sa më shpejtë i Ligjit të ri për Pagat nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, do të ndikoj që të krijohet një sistem i pagave i cili pasqyron saktë të gjitha kategoritë e administratës publike, duke pasqyruar se sistemi aktual i pagave është shumë i fragmentarizuar dhe rrjedhimisht i deformuar në institucionet e administratës publike.

Këshilli vlerëson se disa kategori të nëpunësve civilë, në institucionet e pavarura kushtetuese që ofrojnë shërbime profesionale për trupat e këtyre institucioneve, si Gjykata Kushtetuese, Avokati i Popullit, Komisioni i Pavarur për Media, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Këshilli Gjyqësor, Këshilli Prokurorial, Këshilli i Pavarur Mbikqyrës për Shërbimin Civilë të Kosovës, Agjencia Kundër Korrupsionit, Kuvendi i Kosovës, Zyra e Kryeministrit dhe Zyra e Presidentit dhe eventualisht edhe ndonjë institucion tjetër, duhet që përveç pagës bazë e cila duhet të jetë e njëjtë si tek nëpunësit e institucioneve tjera, me ligjin e ri për pagat, duhet të përcaktohet një shtesë e përhershme në pagën e tyre për shkak të ndjeshmërisë, përgjegjësisë dhe vëllimit të punës.

Këshilli gjatë kryerjes së funksioneve kushtetuese dhe ligjore ka konstatuar se nëpunësit civilë marrin shtesa dhe kompensime në kundërshtim me kushtet dhe kriteret e përcaktuara me dispozitat e Rregullores Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensimet Tjera të Nëpunësve Civilë.

Këshilli konstaton se me dispozitat e kësaj Rregullore, nëpunësit civilë nuk mund të realizojnë shtesa dhe kompensime në shumë mbi 50% të pagës së tyre.

Këshilli konstaton se nëpunësit civilë ende janë duke realizuar shtesa dhe kompensime sipas Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 02/39 të vitit 2008, i cili vendim dhe aktet tjera janë shfuqizuar me dispozitat kalimtare të Rregullores Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensimet Tjera të Nëpunësve Civilë.

Këshilli ka vërejtur raste kur shtesat në pagë janë me të larta se vet paga bazë e nëpunësit civilë, dhe po ashtu ka vërejtur raste kur me emër të kadrove që janë mungesë në tregun e punës (teknologji informative, inxhinierë), shtesa marrin nëpunësit civilë të cilët nuk kanë kualifikimin adekuat mbi bazën e të cilit u takojnë këto shtesa (nëpunës me kualifikim të shkollës së mesme, nëpunës civil nga fusha e studimeve në juridik, ekonomik, etj).

Këshilli konstaton se institucionet e administratës publike kanë vështirësi në plotësimin e pozitave në rastet kur ato janë të lira për shkak të pushimit të lehonisë dhe pensionimit të parakohshëm në shërbimin civil sepse pagesa e pushimit të lehonisë e përcaktuar me ligj dhe e pensionimit të parakohshëm bëhet nga paga e nëpunësit civil i cili ka shkuar në pushim të lehonisë, respektivisht në pensionim të parakohshëm. Po ashtu, edhe të aplikimi i listes teprice të nëpunësve civil nuk është krijuar fond i veçantë i realizimit të pagesave të tyre sipas ligjit.

Duke marr parasysh konstatimet e mësipërme në këtë fushë, Këshilli jep këto rekomandime, që:

1. *Qeveria e Republikës së Kosovës, respektivisht Ministria e Administratës Publike dhe Ministria e Financave, të ndërmarrin të gjitha veprimet për ndalimin e shtesave dhe kompensimeve tjera për nëpunësit civilë, që janë në kundërshtim me dispozitat e Rregullores Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensimet Tjera të Nëpunësve Civilë, dhe që të garantojnë që ato realizohen në pajtim me legjislacionin në fuqi.*
2. *Të gjithë titullarët e institucioneve të administratës publike, të gjitha shtesat në pagë të lejojnë vetëm në bazë të dispozitave të Rregullores Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensimet Tjera të Nëpunësve Civilë.*
3. *Kuvendi i Republikës së Kosovës, gjatë shqyrtimit të Projektligjit për Pagat të ketë parasysh disa kategori të nëpunësve civilë, në institucionet e pavarura kushtetuese që ofrojnë shërbime profesionale për trupat e këtyre institucioneve, si Gjykata Kushtetuese, Avokati i Popullit, Komisioni i Pavarur për Media, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Këshilli Gjyqësor, Këshilli Prokurorial, Këshilli i Pavarur Mbikqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Agjencia Kundër Korrupsionit, Kuvendi i Kosovës, Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, Zyra e Kryeministrit dhe Zyra e Presidentit dhe eventualisht edhe ndonjë institucion tjetër, që përveç pagës bazë, me ligjin e ri për pagat për këto kategori të nëpunësve civil duhet të përcaktohet një shtesë e përhershme në pagën e tyre për shkak të ndjeshmërisë dhe përgjegjësisë së punës si dhe vëllimit të punës.*
4. *Qeveria e Republikës së Kosovës, duhet të gjejë formën e pagesës të pushimit të lehonisë, për pensionimin e parakohshëm të nëpunësve civilë si dhe për stafin teprice në shërbimin civil, në mënyrë që t'i mundësoj institucioneve të administratës publike që të rekrutojnë pozitave e mbetura të lira dhe të cilat ndikojnë në funksionimin normal të institucionit.*

NËPUNESIT CIVILË TË DËNUAR, QË JANË NËN HETIME DHE NDAJ TË CILËVE ËSHTË NGRITUR AKTAKUZË

Këshilli konstaton se Qeveria e Republikës së Kosovës dhe institucionet tjera të administratës publike janë angazhuar që ndaj nëpunësve civilë të dënuar, që janë nën hetime ose është ngritur aktakuzë, të trajtohen në pajtim me dispozitat ligjore të legjislacionit për shërbimin civilë, duke garantuar që në kuadër të shërbimit të mos mbeten ose të pranohen nëpunës civilë me dosje kriminale. Këshilli me këtë rast, vlerëson përkushtimin e krerëve të institucioneve, që këto raste të trajtohen sipas ligjit, duke pezulluar me 50% të pagës nëpunësit civilë ndaj të cilëve ka filluar procedura penale.

Këshilli gjatë vitit 2016 i ka refuzuar të gjitha ankesat që janë parashtruar nga nëpunësit civilë të cilët janë pezulluar nga vendi i tyre i punës për shkak të inicimit të procedurës penale ose ngritjes së aktakuzës.

Këshilli konstaton se procedurat penale, qoftë të hetimit nga prokuroria dhe zhvillimit të procedurave gjyqësore nga gjykatat, në disa raste po zgjaten me vite të tëra, duke shkaktuar dëm në funksionimin normal të institucioneve për shkak se si rrjedhojë e zgjatjes së procedurave penale, vendi i punës i nëpunësit civile mbetet vakant, duke shkaktuar probleme në funksionimin e institucionit edhe për buxhetin e shtetit.

REKOMANDIME

Duke marr parasysh konstatimet e mësipërme në këtë fushë, Këshilli jep këto rekomandime, që:

1. *Të gjithë titullaret e institucioneve të administratës publike që të pezullojnë nga puna me 50% të pagës të gjithë nëpunësit civilë ndaj të cilëve ka filluar procedura penale, respektivisht është ngritur aktakuzë nga Prokurori i Shtetit;*
2. *Ministria e Administratës Publike dhe Qeveria e Republikës së Kosovës, në plotësim-ndryshimin e Ligjit për Shërbimin Civilë të përcaktojnë qartë obligimin që nëse nëpunësi civilë i cili shpallet fajtor nga gjykata për kryrjen e veprave penale që ndërlidhen me vendin e punës, ose e prishin imazhin e shërbimit civilë, pavarësisht dënimit, me automatizëm të shkarkohen nga shërbimi civil;*
3. *Me ligjin e ri të shërbimit civilë të përcaktohet obligimi i pezullimit parandalues me 50% të pagës për nëpunësit civilë ndaj të cilëve është ngritur aktakuzë nga prokurori i shtetit, ndërsa në rastet kur ndaj nëpunësit civilë kanë filluar hetimet, ai duhet të pezullohet vetëm nëse ka një kërkesë nga organet e ndjekjes të cilat kërkojnë që nëpunësi civil të pezullohet për shkak së prania e tij në punë mund të pengojë hetimin.*
4. *Këshilli Prokurorial dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës, të ndërmarr veprime duke kërkuar nga prokurorët dhe gjykatësit që rastet e ngritura ndaj nëpunësve civilë të trajtohen me prioritet.*

CAKTIMI I USHTRUESVE TË DETYRËS

Këshilli gjatë kryerjes së funksioneve kushtetuese dhe ligjore ka konstatuar se institucionet e administratës publike kanë bërë shkelje në shumë raste lidhur me caktimin e ushtruesve të detyrës, duke i caktuar në kundërshtim me legjislacionin e shërbimit civil dhe duke i shkelur afatet e caktimit deri në tre muaj ashtu siç përcaktohet me nenin 30 paragrafi 4 të Ligjit për Shërbimin Civil.

Këshilli konstaton se në disa raste, institucionet e administratës publike, caktojnë ushtrues detyre në kohëzgjatje me shumë se tre muaj më qëllim që kandidatët e caktuar të përfitojnë për të arritur kriterin e përvojës menagjeriale, për të pasur të drejtë pastaj të aplikojnë dhe emërohen në ato pozita.

Në disa raste, institucionet e administratës publike as që kanë filluar procedurat e rekrutimit për emërimin e nëpunësve civilë në pozita të lira në shërbimin civil, duke bërë që këto pozita të mbesin me ushtrues të detyres për vite të tëra.

REKOMANDIME

Duke marr parasysh konstatimet e mësipërme në këtë fushë, Këshilli jep këto rekomandime, që:

1. *Ministria e Administratës Publike, Qeveria dhe Kuvendi i Kosovës me rastin e plotësimit dhe ndryshimit të Ligjit për Shërbimin Civil të përcaktojnë afatet e caktimit të ushtruesit të detyrës, duke marr parasysh kohëzgjatjen e një procedure të rekrutimit, si dhe rastet kur bëhet caktimi i ushtruesve të detyres ose zëvendësimit në rastin kur pozita mbetet vakante për shkak se nëpunësi civilë ka vendim për pezullim parandalues ose pezullim të dakorduar dhe në rastet e plotësimit të pozitave kur nëpunësi civil ka shkuar në pushim të lindjes ose në pushim me dhe pa pagesë.*
2. *Me ligjin e ri të shërbimit civil të përcaktohen sanksione për zyrtarët kryesor administrativ dhe nëpunësit civilë për mosrespektimin e afateve të ushtrimit të detyres së përcaktuar me ligj.*

POZITAT E NIVELIT TË LARTË DREJTUES

Këshilli gjatë kryerjes se funksioneve kushtetuese dhe ligjore ka konstatuar se eprorët e drejtpërdrejtë në disa raste nuk kanë kryer procesin e vlerësimit vjetor të punës për pozitat e nivelit të lartë drejtues.

Po ashtu, Këshilli ka konstatuar se në disa raste, janë lëshuar akt emërimet e përhershme për pozitat e nivelit të lartë drejtues në kundërshtim me legjislacionin i cili ka përcaktuar afatin e emërimit me mandat tre vjeçar.

Këshilli konstaton se legjislacioni sekondar i cili i përcakton kriteret dhe procedurat e emërimit, procedurat e vlerësimit të rezultateve të punës, të vazhdimit të mandatit, të ricaktimit, procedurat disiplinore dhe të ankesave, në disa raste nuk janë në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe ka zbraztira ligjore sepse nuk rregullojnë të gjitha aspektet që ndërlidhen me këto pozita në degën e ekzekutivit, të legjislativit, në agjencitë dhe institucionet e pavarura.

Këshilli konstaton se mandati prej tri vitesh për pozitat e nivelit të lartë drejtues është mandat i shkurtër dhe si i tillë ndikon negativisht në realizimin e objektivave afatmesme dhe aftagjata për institucionet e administratës publike.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës konstaton se Qeveria e Republikës së Kosovës duhet që të analizoj funksionimin e deritanishëm të Këshillit për Pozitat e Nivelit të Lartë Drejtues të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe varësisht nga funksionimi i deritanishëm të nxjerr rekomandime për të përcaktuar mandatin e këtij Këshilli në sistemin e emërimit, menaxhimit dhe funksionimit të pozitave të nivelit të lartë drejtues për degën e ekzekutivit.

REKOAMNDIME

Duke marr parasysh konstatimet e mësipërme në këtë fushë, Këshilli jep këto rekomandime, që:

1. *Ministria e Administratës Publike, Qeveria dhe Kuvendi i Republikës së Kosovës, me rastin e plotësimit dhe ndryshimit të Ligjit për Shërbimin Civilë të përcaktojnë kriteret dhe procedurat e emërimit të sekretarëve të përgjithshëm dhe pozitave të barazvlefshme, duke shiquar mundësinë e ri modelimit të emërimit në pozita të nivelit të lartë drejtues, me theks të veçantë për pozitat e sekretarëve të përgjithshëm. Këshilli rekomandon që mandati i pozitave të nivelit të lartë drejtues duhet të jetë 5 vjeçar.*
2. *Të rivlerësohet përbërja dhe mandati i Këshillit për Pozitat e Nivelit të Lartë Drejtues, duke i përcaktuar mandat shtesë në menaxhimin e proceseve që ndërlidhen me pozitat e nivelit të lartë drejtues.*
3. *Derisa nuk ndryshohet legjislacioni aktual i shërbimit civil, Këshilli i rekomandon Qeverisë së Republikës së Kosovës, që urgjentisht të plotësohet dhe ndryshohet Rregullorja Nr. 06/2010 për Procedurat e Emërimit në Pozita të Larta Drejtuese në*

Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregulloren Nr. 06/2012 për Pozitat e Larta Drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, duke vlerësuar gjendjen aktuale dhe duke marr parasysh që se bashku me Kuvendin të përcaktojnë edhe pozitat e nivelit të lartë drejtues në institucionet dhe agjencitë e pavarura që i përgjigjën Kuvendit të Republikës së Kosovës.

PËRFAQËSIMI I PERSONAVE ME NEVOJA TË VEÇANTA

Këshilli konstaton se përfaqësimi i personave me nevoja të veçanta në shërbimin civil të Kosovës duhet të rritet nga institucionet e administrates publike.

Në këtë drejtim është vërejtur një përmirësim sepse institucione të caktuara, si Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe institucione tjera, kanë hapur konkurse të veçanta për pranimin në shërbimin civil të personave me nevoja të veçanta.

Këshilli i ka rekomanduar Ministrisë së Administratës Publike që në Rregulloren e re për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të përcaktojnë dispozita që parashohin procedura të veçanta të testimit me shkrim dhe me gojë, duke ju përshtatur kategorive të personave me nevoja të veçanta.

Këshilli konstaton se në Ligjin për Shërbimin Civil nuk është përcaktuar kuota e përfaqësimit të personave me nevoja të veçanta.

Këshilli nga viti 2017, në Pytësorin e ri të Monitorimit të institucioneve të administrates publike ka përcaktuar si fushë të monitorimit përfaqësimin e personave me nevoja të veçanta dhe gjatë kryerjes së këtij procesi në secilin institucion do të prezentoj të gjeturat dhe do ti jap rekomandimet konkrete për institucionin duke marr parasysh kuotat e përcaktuara me Ligjin për aftësim dhe riaftësim profesional për personat me aftësi të kufizuara në të cilin parashihet që çdo i 50-ti punëtor të jetë me aftësi të kufizuara.

Po ashtu, Këshilli ka vendosur që të nxjerr një Raport të veçantë gjatë vitit 2017 në menyrë që të pasqyrohet me statistika të sakta se sa është numri i personave me aftësi të kufizuara në shërbimin civil, dhe duke adresuar rekomandimet për institucionet kompetente.

REKOMANDIM

Duke marr parasysh konstatimet e mësipërme në ketë fushë, Këshilli jep këto rekomandime, që:

1. *Deri në nxjerrjen e Ligjit të ri për shërbimin civil, institucionet e administrates publike të ndermarrin veprime për punësimin e personave me nevoja të veçanta duke u bazuar në Ligjin për aftësim dhe riaftësim profesional për personat me aftësi të kufizuara në të cilin parashihet që çdo i 50-ti punëtor të jetë me nevoja të veçanta;*
2. *Ministria e Administratës Publike, Qeveria dhe Kuvendi me Ligjin e ri të shërbimit civil të përcaktojnë një dispozitë ligjore që përcakton kuotën që se paku çdo i 50-ti nëpunës civil të jetë person me nevoja të veçanta në institucionet e administrates publike.*

TRAJNIMET NË SHËRBIMIN CIVILË

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në kuadër të mandatit kushtetues dhe ligjor për mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, gjatë zbatimit të funksionit për shqyrtimin e ankesave të nëpunësve civil, për vëzhgimin e procedurave të avancimit/rekrutimit të pozitive të nivelit drejtues si dhe funksionit të monitorimit të zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil të institucioneve të administrates publike në nivel qendror dhe lokal, ka evidentuar shkeljet e bëra, sfidat dhe mangësitë në kryerjen e detyrave dhe përgjegjësisë nga nëpunësit civil.

Duke u bazuar në të gjitha të gjeturat dhe konstatimet e Këshillit si dhe duke marr parasysh kërkesat e vazhdueshme nga nëpunësit civil, menaxherët e personelit dhe zyrtarët kryesor administrativ të institucioneve, për trajtimin e mangësive të evidentuara ligjore dhe procedurale, gjithnjë me qëllim të trajnimit dhe aftësimit të nëpunësve civil dhe krijimit të një administrate të përgjegjshme dhe profesionale, Këshilli ka identifikuar fushat në të cilat është e domosdoshme që të organizohen trajnime për nëpunësit civil të nivelit drejtues dhe profesional.

Duke respektuar kompetencat dhe përgjegjësitë e Institutit të Kosovës për Administratë Publike, posaqërisht në identifikimin dhe vlerësimin, në mënyrë periodike të nevojave për aftësimin e nëpunësve civil të Kosovës në nivelin qendror dhe lokal, në hartimin e programeve të përshtatshme të aftësimit që përmbushin nevojat e identifikuar, ofrimin e trajnimeve për aftësimin e nëpunësve civilë në nivelin qendror dhe lokal si dhe në koordinimin e aktiviteteve me institucionet në nivelin qendror dhe lokal, Këshilli ju rekoandon trajnimet, si në vijim:

1. E drejta administrative;
2. Procedura e rekrutimit në shërbimin civil;
3. Procedurat e avancimit në shërbimin civil;
4. Procedurat e transferimit në shërbimin civil;
5. Procedura Disiplinore, ndërprerja, pezullimi dhe përfundimi i mardhënies së punës në shërbimin civil;
6. Procedura e zgjidhjes së kontesteve dhe ankesave në shërbimin civil;
7. Procedurat e rekrutimit të drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve të institucionit edukativo- arsimor dhe aftësues;
8. Rregullimi dhe përmbajtja e dosjeve të personelit të nëpunësve civil;
9. Puna provuese në shërbimin civil;
10. Vlerësimi i rezultateve në punë për nëpunësit civil;
11. Procedurat e pushimeve të nëpunësve civil.
12. Konflikti administrativ.

Për nevojën e organizimit të trajnimeve të veçanta sipas fushës së propozuar, janë marr parasysh edhe faktet dhe të dhënat e konstatuara gjatë zgjidhjes së ankesave, gjatë procesit të monitorimit të institucioneve si dhe gjatë procesit të vëzhgimit të procedurave të rekrutimit. Ka pasur shumë raste kur për shkak të gabimeve, paqartësive apo moszbatimit të saktë të dispozitës ligjore nga zyrtarët apo komisionet përkatëse, Këshilli ka anuluar procedurat e rekrutimit, procedurat e transferimit, dhe poashtu në shumë raste Këshilli ka kthyer në punë shumë nëpunës civilë që kanë bërë shkelje por ndaj të cilëve nuk janë ndërmarr veprimet procedurale disiplinore apo të

zgjidhjes së ankesës në pajtim me procedurën dhe ligjin, dhe që të gjitha këto pastaj kanë efekte negative për administratën në përgjithësi por edhe për buxhetin e Republikës së Kosovës.

NËPUNËSIT CIVILË TË INSTITUCIONEVE TË PAVARURA KUSHTETUESE

Këshilli i Pavarur Mbikëqyres ka përcjellur me vëmendje çështjet e ngritura lidhur me nëpunësit civilë të institucioneve të pavarura kushtetuese, respektivisht ruajtjen e pavarësisë funksionale të institucioneve të pavarura, gjatë zbatimit të legjislacionit për shërbimin civilë.

Këshilli konstaton se Gjykata Kushtetuese në rastin nr. KO73/16 të parashtruar nga Avokati i Popullit ka nxjerr Aktgjykim me datën 16 nëntor 2016, duke konstatuar se Qarkorja Administrative nr. 01/2016 e nxjerrë më 21 janar 2016 nga Ministria e Administratës Publike të Republikës së Kosovës, në tërësi cenon pavarësinë e institucioneve të pavarura të parapara me Kushtetutë, dhe është jokushtetuese në raport me ato institucione të pavarura.

Për njoftim, Gjykata Kushtetuese nuk ka dorëzuar kërkesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyres për Shërbimin Civil të Kosovës për të dhënë komentet lidhur me rastin e ngritur nga Avokati i Popullit. Konsiderojmë se Këshillit është dashur t'i dërgohet kjo kërkesë për komente sepse duke marr parasysh nenin 101 pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Këshilli i Pavarur Mbikëqyres për Shërbimin Civil të Kosovës, është institucion kushtetues që siguron respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil. Në këtë frymë, Këshilli do të jepte kontributin e vet profesional, në kuadër të mandatit kushtetues dhe ligjor, përmes komenteve të cilat besojmë se do t'i ndihmonin Gjykatës Kushtetuese për të trajtuar dhe vendosur lidhur me rastin e ngritur. Mirëpo, ka qenë në vlerësimin e tyre, që të mos dërgojnë kërkesë për komente në Këshill, dhe ne si të tillë e respektojmë, duke shprehur paralelisht, gatitshmerinë tonë për bashkëpunim ndërinstitucional në kuadër të mandatit kushtetues dhe ligjor të institucioneve tona.

Këshilli konstaton se çështja e ngritur, e trajtuar dhe vendosur pastaj nga Gjykata Kushtetuese e prekë pjesërisht vetëm një segment të çështjes lidhur me pavarësinë e institucioneve kushtetuese dhe se para se gjithash, kjo çështje nuk është vetëm e një akti administrativ, por është çështje ligjore e cila duhet të zbatohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Këshilli konstaton se me Ligjin për Shërbimin Civilë është përcaktuar se duhet të respektohet pavarësia kushtetuese gjatë zbatimit të tij, respektivisht kjo është përcaktuar me nenin 3 paragrafi 7 të Ligjit për Shërbimin Civil: ***“Gjatë zbatimit të këtij ligji, respektohet pavarësia kushtetuese e institucioneve të pavarura nga ekzekutivi”***. Këshilli konstaton se deri në plotësim të Ligjit për Shërbimin Civil, Qeveria e Kosovës, respektivisht Ministria e Administratës Publike dhe Ministria e Financave duhet të bashkëpunojnë ngushtë me institucionet e pavarura kushtetuese për të përcaktuar dhe definuar çështjet me të cilat konsiderohet se janë ndërhyrje në pavarësinë e institucioneve të pavarura, duke përgatitur dhe nxjerr një akt nënligjor i cili i definon këto çështje, me qëllim që gjatë zbatimit të legjislacionit të mos krijohen dilema të cilat do të demtonin proceset dhe do të ndikonin në funksionimin e institucioneve të pavarura.

Këshilli i Pavarur Mbikeqyres ka pas takime me përfaqësues të disa institucioneve të pavarura dhe me Minsitrinë e Administratës Publike, dhe është i gatshëm që në kuadër të mandatit të vet kushtetues dhe ligjor të jep kontributin e vet aktivë në këtë proces.

REKOMANDIM

Duke marr parasysh konstatimet e mësipërme në këtë fushë, Këshilli jep këto rekomandime, që:

- 1. Deri në plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Shërbimin Civilë, institucionet e pavarura kushtetuese dhe Qeveria e Republikës së Kosovës, respektivisht Ministria e Administratës Publike dhe Ministria e Financave, të përcaktojnë listen e çështjeve të ngritura të cilat ndikojnë në pavarësinë e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të nxjerrin akt nënligjor që përcaktojnë dhe definojnë qartë këto çështje, në mënyrë që gjatë zbatimit të legjislacionit të shërbimit civil të ruhet pavarësia funksionale e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të mos krijohen paqartësi të cilat do të ndikonin në realizimin e objektivave të institucioneve të pavarura.*
- 2. Me plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Shërbimin Civil të përcaktohen në mënyrë taksative çështjet të cilat gjatë zbatimit të legjislacionit të shërbimit civilë, ruajnë pavarësinë funksionale të institucioneve të pavarura kushtetuese.*

14. VENDIMET E GJYKATAVE

Gjatë periudhës raportuese bazuar në të dhënat që posedojmë, rezulton se Këshilli ka pranuar 199 Vendime nga gjykatat e vendit, prej tyre 153 aktgjykime dhe 46 aktvendime.

Këshilli konstaton se me 123 Aktgjykime të gjykatave të vendit janë refuzuar kërkesëpaditë e paditësve kundër vendimeve të Këshillit duke u vërtetuar vendimet e Këshillit.

Me 29 Aktgjykime të gjykatave të vendit janë aprovuar kërkesëpaditë e paditësve kundër vendimeve të Këshillit duke u anuluar 29 vendime të Këshillit të cilat janë kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje në Këshill. Ndërsa, vetëm me 1 aktgjykim është vendosur përfundimisht për kërkesëpadinë e paditësit duke u anuluar vendimin e Këshillit, mirëpo për këtë rast Këshilli ka parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit dhe presim që Gjykata e Apelit do të aprovojë ankesën e Këshillit sepse konsiderojmë se vendimi i Këshillit është nxjerr në pajtim me gjendjen faktike dhe juridike.

Gjykatat kanë nxjerr 46 aktvendime, me të cilat kanë vendosur që të hedhën poshtë paditë e paditësve, që të pezullohet procedura, që të ndërpritet procedura pasi që janë tërhequr paditë dhe në disa raste janë shpallur jo kompetent për të vendosur për kërkesëpaditë e paditësve.

Aktgjykimet dhe aktvendimet e gjykatave janë nxjerr për vendimet e Këshilli në vitet paraprake, por që janë vendosur nga Gjykatat në vitin 2016.

15. BASHKËPUNIMI I KËSHILLIT ME INSTITUCIONET TJERA

Këshilli gjatë vitit 2016, përveç kryerjes së detyrave dhe përgjegjësive ligjore, i ka kushtuar rëndësi të madhe edhe ngritjes së bashkëpunimit me institucionet vendore dhe ndërkombëtare.

Në kuadër të bashkëpunimit me institucionet vendore, ka pasur bashkëpunim shumë të mirë me Kuvendin e Kosovës, Qeverinë e Republikës së Kosovës, respektivisht Ministrinë e Administratës Publike. Po ashtu, Këshilli i ka ofruar bashkëpunim të plotë Institutit të Kosovës për Administratë Publike, Institutit Gjyqësor të Kosovës, Agjencisë Kundër-Korrupsionit, Avokatit të Popullit, Prokurorisë së Shtetit dhe Policisë së Kosovës si dhe institucioneve tjera, lidhur me rastet që janë kërkuar dhe vlerësimin e tyre, në kuadër të funksioneve dhe përgjegjësive kushtetuese të Këshillit për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në shërbimin civil.

Këshilli gjatë vitit 2016, në kuadër të bashkëpunimit me jashtë, ka pritur në një vizitë Komisionerën e Shërbimit Civil të Republikës së Shqipërisë. Ka marrë pjesë në konferencën “Drejtësia Administrative në Ballkanin Përendimorë” të mbajtur në Podgoricë nën organizimin e Shkolles Regjionale për Administratë Publike dhe në bashkëpunim me Gjykatën Administrative të Malit të Zi.

Gjithashtu, Këshilli, ka pasur një bashkëpunim të hapur me mediat elektronike dhe mediat e shkruara, me shoqërinë civile, duke ju mundësuar prezencë fizike në çdo organizim të Këshillit si dhe duke ju ofruar qasje në çdo dokument apo informacion të kërkuar.

16. KRAHASIMI I PUNËS SË KËSHILLIT PËR VITIN 2016 ME PUNËN E KËSHILLIT PËR VITIN 2015

16.1. Funksioni i shqyrtimit të ankesave

Në tekstin në vijim do të paraqiten të dhënat për punën e Këshillit për vitin 2016 në krahasim me punën e Këshillit për vitin 2015, në pajtim me kërkesën dhe formatin e raportit të punës.

Në vitin 2016 në Këshill janë pranuar gjithsej 596 ankesa kurse në vitin 2015 në Këshill janë pranuar 613 ankesa.

Nga kjo e dhënë, konstatohet që në Këshill gjatë vitit 2016 janë pranuar 17 ankesa më pak se ankesat e pranuar në vitin 2015.

Këshilli, gjatë vitit 2016 përveç 596 ankesave të pranuar, në shqyrtim ka pasur edhe 58 ankesa të cilat janë bartur nga viti 2015 për vendosje në vitin 2016. Bazuar në këto të dhëna, rezulton që Këshilli gjatë vitit 2016 ka pasur në shqyrtim gjithsej 654 ankesa ndërsa që Këshilli në vitin 2016 ka vendosur në mënyrë meritore për 571 ankesa, ndërsa 83 ankesa janë bartur për tu vendosur në vitin 2017.

Nga këto të dhëna konstatohet që Këshilli gjatë vitit 2016 ka pasur në shqyrtim 17 ankesa më pak se në vitin 2015.

Këshilli në vitin 2016 ka vendosur në mënyrë meritore për 36 ankesa më pak se në vitin 2015. Nga viti 2016 në vitin 2017 janë bartur 25 ankesa më shumë se ankesat e bartura nga viti 2015 në vitin 2016.

Në vitin 2016 organet e punësimit kanë pasur për obligim zbatimin e 209 vendimeve të Këshillit, prej 209 vendimeve, organet e punësimit kanë zbatuar 181 vendime, nuk kanë zbatuar 28 vendime.

| Nr. | Ankesat/Vendimet | Viti 2016 | Viti 2015 | Ndryshimi | Krahasimi i ankesave dhe vendimeve në mes të vitit 2016 dhe 2015 |
|-----|---|-----------|-----------|-----------|--|
| 1. | Ankesat e pranuar | 596 | 613 | 17 | Këshilli në vitin 2016 ka pranuar 17 ankesa më pak se në vitin 2015 |
| 2. | Ankesat për shqyrtim në Këshill | 654 | 690 | 36 | Këshilli në vitin 2016 ka pasur në shqyrtim 36 ankesa më pak se në vitin 2015 |
| 3. | Ankesat e Këshillit (Numri i vendimeve) | 571 | 632 | 61 | Këshilli në vitin 2016 ka nxjerrë 61 vendime më pak se në vitin 2015 |
| 4. | Vendimet e obligueshme për zbatim | 209 | 263 | 54 | Organet e punësimit në vitin 2016 kanë pasur obligim për zbatimin e 54 vendimeve më pak se në vitin 2015 |
| 5. | Vendimet e zbatuara | 181 | 221 | 40 | Pasi që ka pasur më pak vendime për zbatim në vitin 2016 numri i vendimeve të zbatuara është 42 më pak |
| 6. | Vendimet e pazbatuara | 28 | 41 | 13 | Në vitin 2016 kanë ngelur pa u zbatuar 28 vendime ndërsa në vitin 2015 nuk janë zbatuar 41 vendime. |
| 7. | Ankesat e bartura në vitin vijues | 83 | 58 | 25 | Nga viti 2016 në vitin 2017 janë bartur 25 ankesa më shumë se nga viti 2015 në vitin 2016 |

Tabela nr.16 paraqet krahasimin e ankesave të pranuar, ankesave në shqyrtim si dhe vendimet e nxjerra gjatë vitit 2016 dhe 2015.

16.2. Funkzioni i vëzhgimit të procedurës së rekrutimit të nëpunësve civilë të nivelit drejtues

Këshilli gjatë vitit 2016 ka marrë pjesë në 248 procedura të vëzhgimit lidhur me procesin e emërimeve të nëpunësve civilë të nivelit drejtues në të cilat kanë qenë 248 pozita. Nga 248 pozita që janë vëzhguar, Këshilli ka aprovuar 104 pozita të rekrutimit ndërsa ka anuluar 144 pozita të rekrutimit për shkak të shkeljeve ligjore dhe procedurale.

Në bazë të këtyre të dhënave, vërehet që Këshilli në vitin 2016 ka vëzhguar 180 procedura të rekrutimit të nëpunësve civilë të nivelit drejtues më shumë se në vitin 2015.

Këshilli në vitin 2016 ka aprovuar 70 procedura të rekrutimit të nëpunësve civilë të nivelit drejtues më shumë se në vitin 2015.

Këshilli në vitin 2016 ka anuluar 110 procedura të rekrutimit të nëpunësve civilë të nivelit drejtues më shumë se në vitin 2015.

| Nr. | Procedura e vëzhgimit | Viti 2016 | Viti 2015 | Ndryshimi | Krahasimi i procedurës së vëzhgimit |
|-----|--|-----------|-----------|-----------|---|
| 1 | Procedurat e vëzhgimit lidhur me procesin e emërimeve të nëpunësve civil të nivelit drejtues | 248 | 68 | 180 | Këshilli në vitin 2016 ka vëzhguar 180 pozita të rekrutimit më shumë se në vitin 2015 |
| 2 | Procedurat e aprovuara | 104 | 34 | 70 | Këshilli në vitin 2016 ka aprovuar 70 pozita të rekrutimit më shumë se në vitin 2015 |
| 3 | Procedurat e anuluar | 144 | 34 | 110 | Këshilli në vitin 2016 ka anuluar 110 pozita të rekrutimit më shumë se në vitin 2015 |

Tabela nr.17 paraqet krahasimin e procedurës së vëzhgimit për vitin 2016 dhe 2015

16.3. Funkzioni i mbikëqyrjes së zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil

Këshilli për vitin 2016, ka planifikuar të monitorojë 77 institucione, ka realizuar 57 vizita monitoruese dhe ka përgatitur pesëdhjetegjashtë 56 raporte të mbikëqyrjes së zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil.

Në raportet e vitit 2016 të mbikëqyrjes së zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil për 56 institucione të nivelit qendror dhe lokal, Këshilli, ka evidentuar dhe ka konstatuar **337** shkelje të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, dhe për shkeljet e evidentuara ka dhënë **245** rekomandime për zyrtarët përgjegjës të institucioneve të monitoruara.

Këshilli në vitin 2015, ka planifikuar të monitorojë 71 institucione të nivelit qendror dhe lokal ndërsa janë realizuar 41 vizita monitoruese, kjo nënkupton që Këshilli në vitin 2016 ka planifikuar të monitoroj 6 institucione më shumë se në vitin 2015 po ashtu janë realizuar 16 vizita më shumë se në vitin 2015.

Këshilli në vitin 2016 për shkak të kapaciteteve dhe mungesës së buxhetit nuk ka arritur të realizojë në tersi planin e monitorimit të miratuar, ku në bazë të planit Këshilli nuk ka realizuar 20 monitorime të parapara me Planin e Monitorimit.

| Nr. | Funksioni i mbikëqyrjes | Viti 2016 | Viti 2015 | Ndryshimi | Krahasimi i procedurës së mbikëqyrjes për vitin 2016 dhe 2015 |
|-----|-------------------------------------|-----------|-----------|-----------|---|
| 1 | Vizitat monitoruese të planifikuara | 77 | 71 | 6 | Këshilli në vitin 2016 ka planifikuar të monitorojë 6 institucione më shumë se në vitin 2015. |
| 2 | Vizitat monitoruese të realizuara | 57 | 41 | 16 | Këshilli në vitin 2016 ka monitoruar 16 institucione më shumë se në vitin 2015. |
| 3 | Vizitat monitoruese të porealizuara | 20 | 30 | 10 | Këshilli në vitin 2016 nuk ka realizuar 20 monitorime kurse në vitin 2015 nuk ka realizuar 30 monitorime të parapara me Planin e Monitorimit. |

Tabela nr.18 paraqet krahasimin e procedurës së mbikëqyrjes për vitin 2016 dhe 2015

17. RAPORTI PËR SHPENZIMIN E BUXHETIT TË KËSHILLIT

Buxheti fillestar i aprovuar për Këshillin, sipas Ligjit 05/L-071 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016, ka qenë në shumën prej **292.734.00 Euro**. Buxheti i rishikuar sipas Ligjit 05/-109 dhe buxheti final-SIMFK, ka qenë në shumën prej:307.734.00 **Euro**.

| Nr | Kategoritë Ekonomike | Buxheti fillestar aprovuar sipas Ligjit 05/L-071 | Me rishikim të buxhetit ,sipas ligjit të buxhetit nr. 05/L-109 | Ndryshimi | Buxheti Final-SIMFK |
|----|----------------------------|--|--|------------------|---------------------|
| 1 | Paga dhe mëditje | 236.507.00 | 236.507.00 | 00 | 236.507.00 |
| 2 | Mallra dhe shërbime | 52.402.00 | 67.402.00 | 15.000.00 | 67.402.00 |
| 3 | Shpenzime komunale | 3.825.00 | 3.825.00 | 00 | 3.825.00 |
| 4 | Shpenzime kapitale | 00 | 00 | 00 | 00 |
| | Totali | 292.734.00 | 307.734.00 | 15.000.00 | 307.734.00 |

Tabela nr. 19 paraqet alokimin e mjeteve sipas kategorive ekonomike

Nga tabela e mësipërme, shihet qartë se ka dallim në mes të buxhetit të aprovuar dhe buxhetit final në total 15.000.00€.

Në kategorinë ekonomike **Paga dhe Mëditje**, buxheti fillestar i aprovuar ,ashtu edhe buxheti final i Këshillit ka mbetur i njëjtë në shumë prej:.....236.507.00€

Në kategorinë ekonomike **Mallra dhe Shërbime** për vitin 2016 ,buxheti fillestar i aprovuar është në shumë prej:.....52.402.00€

Në kategorinë ekonomike **Mallra dhe Shërbime** për vitin 2016 ,buxheti final i aprovuar është në shumë prej:.....67.402.00€

Në kategorinë ekonomike **Mallra dhe Shërbime** për vitin 2016,buxheti final është rritur me rishikim të buxhetit në shumë prej:.....15.000.00€

Në kategorinë ekonomike **Shpenzime komunale** për vitin 2016, buxheti ka mbetur i njëjtë, nuk ka pësuar ndryshime ligjore.

Gjatë vitit 2016, nga buxheti i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, Këshilli ka shpenzuar në total: **96.91%** të buxhetit. Buxheti i shpenzuar në kategoritë ekonomike është si vijon:

Në kategorinë ekonomike Paga dhe Mëditje: Buxheti është shpenzuar në masën prej **98.06%**.

Në kategorinë ekonomike Mallra dhe Shërbime: Buxheti është shpenzuar në masën **94.71%**.

Në kategorinë ekonomike Shpenzime komunale: Buxheti është shpenzuar në masën **64%**.

| Nr. | Kodi buxhetor | Buxheti final | Të shpenzuara | Të pa-shpenzuara | Të shprehura në% |
|-----|----------------------------|---------------|---------------|------------------|------------------|
| 1 | Paga dhe mëditje | 236.507.00 | 231.927.37 | 4.579.63 | 98.06 |
| 2 | Mallra dhe shërbime | 67.402.00 | 63.836.91 | 3.565.09 | 94.71 |
| 3 | Shpenzime komunale | 3.825.00 | 2.448.44 | 1.376.56 | 64% |
| 4 | Shpenzime kapitale | 00 | 000 | 000 | 000 |
| | Totali | 307.734.00 | 298.212.72 | 9.521.28 | 96.91% |

Tabela nr. 20 paraqet shpenzimet e buxhetit sipas kategorive ekonomike